

Me KSHZ-në,
VMRO tenton
ta bllokojë
referendumin

Fq.3



SIR ALAN
DUNCAN

Ballkani
Perëndimor
është i rëndësishëm

Fq.2



PSZH jep
270 mln
euro për
Kutinjon

Fq.21



Koha

www.koha.mk



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3409 · e martë, 10 korrik 2018

16°C | 27°C

15 DEN

EDITORIAL

Betejat
europiane të
ballkanasve



Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vučić, zhvilloi dje një bisedë telefonike me kancelaren gjermane Angela Merkel dhe, sipas asaj që prezantoi shtypi serb, në qendër të kësaj bisede ka qenë ndërtimi i rrugës Nish-Prishtinë. Vučići ka kërkuar nga kancelarja që të ndikojë, në kuadër të Samitit për Ballkanin Perëndimor që po mbahet në Londër e që është vazhdimësi e Procesit të Berlinit, në përshtetimin e këtij projekti, i cili, sipas Vučićit, qenka e "një rëndësie të veçantë". Bashkëpunimi rajonal, të cilin aq shumë e proklamojnë...

Fq.2

RAJON

Pse po
largohen
serbët nga
FSK?

Fq.16

GLOBI

Mendojeni
Sirinë
të paktën
dy minuta

Fq.17



ANKOHEN AUTORITETET E KOMUNËS SË TETOVËS

BANESAT SOCIALE LARG TETOVËS!



"Deri më tani, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale janë ndërtuar 13 ndërtesa. Statistikisht 660 banesa edhe atë në Kriva Pallankë 44, Kavar 30, Berovë 51, Makedonska Kamenicë 29, Kërçovë 32, Koçan 29, Manastir 78. Fatkeqësisht, ka një diskriminim të madh në shpërndarjen gjeografike të këtyre banesave sociale", tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës

Fq.9

A do të pësojë cilësia e shërbimeve?

Tetovë, 9 korrik - Reformat në shëndetësi nga qeveria e re kanë nisur mbarë. Këtë e ka bërë të ditur kryeministri Zoran Zaev, por edhe ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe. Të dy krerët kanë paralajmëruar se nga 1 janari i viti 2019 do të ketë trajtim falas në spital për të gjithë qytetarët. Deri më tani, ky trajtim ishte vetëm për fëmijët e pranuesve të asistencës sociale, dhuruesit të gjakut dhe disa kategori të tjera të pa-

cientëve. Raporti i Fondit për siguri shëndetësore për vitin 2017 tregon që, në lidhje me participimet janë harxhuar 436.608.000 milion denarë. Në 2016 kjo shumë ka arritur 415.020.000 milionë denarë. Mjekët dhe drejtorët e spitaleve (nuk dëshirojnë që publikisht ta komentojnë informatën e lirimit nga participimi), thonë se për afat të gjatë mund të ndikojë negativisht në sistemin shëndetësor...

Fq.7



EDITORIAL

BETEJAT EUROPIANE
TË BALLKANASVE

Emin AZEMI

Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, zhvilloi dje një bisedë telefonike me kancelaren gjermane Angela Merkel dhe, sipas asaj që prezantoi shtypi serb, në qendër të kësaj bisede ka qenë ndërtimi i rrugës Nish-Prishtinë. Vuçiqi ka kërkuar nga kancelarja që të ndikojë, në kuadër të Samitit për Ballkanin Perëndimor që po mbahet në Londër e që është vazhdimësi e Procesit të Berlinit, në përshtetimin e këtij projekti, i cili, sipas Vuçiqit, qenka e "një rëndësie të veçantë".

Bashkëpunimi rajonal, të cilin aq shumë e proklamojnë zyrtarët serbë, është kuptuar njëanshëm dhe para se të marrin ndonjë përgjigje konkrete nga kancelarja Merkel, ata është mirë të sqarojnë arsyet e maltremit të kosovarëve që kalojnë nëpër autostradat e Serbisë. Janë po ato autostrada që Vuçiqi ka dëshirë t'i lidhë me transversalen Nish-Prishtinë, e ku janë evidentuar disa raste kur shtetas të Kosovës, ose janë kthyer mbrapsht në kufi dhe nuk iu është lejuar të vazhdojnë udhëtimin më tutje, ose janë ndalur në ndonjë pritë policore dhe pa dhënë shpjegime të hollësishme janë dërguar në paraburgim.

Procesi i Berlinit, sikundër dihet, është një iniciativë e nisur nga kancelaria gjermane Angela Merkel, në 2014. Çdo vit, ai mbledh bashkë 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, partnerë të BE dhe përfaqësues të institucioneve europiane, për të punuar së bashku në mbështetje të sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon.

Serbia, e cila po vetëtrajtohet si faktor stabiliteti në rajon, i ka kuptuar shumë njëanshëm këto lëvizje europiane që po ndodhin. Nuk mundet të kesh aq shumë ambicie përfituese nga Procesi i Berlinit, ndërkohë që vazhdon politika milloshieviane e trajtimit të Kosovës. Zyrtarët në Bruksel dhe në qendrat tjera të vendimmarrjes nuk do të duhej ta amnistojnë aq shpejt Serbinë nga mendësia e saj antieuropiane, sidomos në raport me qytetarët e Kosovës, të cilët udhëtimin nëpër Serbi ende e konsiderojnë si ferr të vërtetë. Është paradoksale të mbyllen sytë para kësaj Serbie, e cila në njërin anë sillet aq brutalisht me kosovarët, kurse në anën tjetër - kërkon nga liderët europianë të përshtetimin ndërtimin e rrugëve që do ta nxirrin atë më shpejt në detin e Adriatik. Nga do të kalojnë ato rrugë? Pse Serbia, e cila paska aq shumë interes nga modernizimin i rrugëve rajonale, sillet sikur nuk ekzi-

ston Kosova dhe shqiptarët, ndërkohë që jo pak përfaqësues të jetës politike e shoqërore serbe tash me kanë pranuar se Kosova është e humbur përgjithmonë për Serbinë.

"Jemi përshkruar si shtet që ka fshehur krimet dhe katastrofën humanitare mbi shumicën shqiptare në Kosovë, që ka kërcënuar paqen rajonale dhe botërore, e në raste të tilla intervenimi i armatosur ndërkombëtar është i lejueshëm... Shumica e shteteve anëtare të OKB-së dhe pothuaj të gjitha shtetet e BE-së dhe NATO-s, e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës", tha këto ditë njëri prej liderëve nacionalistë serbë, Vuk Drashkoviç, i cili njihet në të kaluarën për qëndrimet e tija të forta kundër Kosovës.

Fryma antikosovare që mbretëron në politikën zyrtare serbe nuk korrespondon me nismat europiane për bashkëpunim dhe mirëkuptim rajonal. Brukseli, Berlioni dhe qendrat tjera europiane e kanë shumë gabim kur sillen me kaq përkëdheli ndaj Beogradit dhe shoqërisë serbe në përgjithësi. Është po ajo shoqëri që nga gjui i vet nxjerr media me përmbajtje fashiste, ku disponimi anti-shqiptar, antikroat, antiamerikan shfaqet shumë hapur dhe papengueshëm. Mjafton të bëhet një shëtitje e shkurtër nëpër faqet e para të gazetave serbe ku dominojnë tituj të turpshëm që stigmatizojnë të gjithë ata që bëjnë tifo për Kroacinë në kuadër të botërorit që po mbahet në Rusi. Pse po deshka të tolerohet kjo gjuhë rrugaçësh e mediave të Beogradit dhe a duhet që ky çmim tolerance i zyrtarëve europiane të vendosjes të kuptohet si dekurajim për përpjekjet e popujve të Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë edhe Kosova e Kroacia, në betejat e tyre antihegemoniste serbe. Brukseli dhe Uashingtoni do të duhej madje t'i shpërblejnë këto përpjekje, sepse ato në instance të fundit ishin bedema që mbronin Europën nga ndikimi arbitrar rus. Fronti evropian i ruajtjes së vlerave nga invadimet Lindore nuk është një vijë imagjinare, por një betejë konkrete që popujt liridashës të Ballkanit e kanë zhvilluar, për çka edhe do të duhej të meritojnë jo vetëm mirënjohje verbale, por edhe mbështetje konkrete. Nëse vazhdon përkëdhelja e Serbisë nga ana e burokratëve të caktuar të Brukselit, ky do të ishte në fakt akti më i turpshëm që iu bëhet atyre ballkanasve që gjatë gjithë këtyre dekadave u angazhuan për stabilitet dhe mirëqenie europiane.

BALLKANI PERËNDIMOR
ËSHTË I RËNDËSISHËM

Sir Alan DUNCAN

Këtë javë, Mbretëria e Bashkuar do të mirëpresë liderët nga e gjithë Evropa për samitin që ka të bëjë me të ardhmen e Ballkanit Perëndimor.

Takimi vjen në një kohë të rritjes së optimizimit në rajon. Greqia dhe Maqedonia kanë bërë përparim drejt zgjidhjes së çështjes së emrit, duke shfaqur se si ndryshimi mund të ndodhë shpejt kur qeveritë i dedikohen vlerave evropiane.

Mbretëria e Bashkuar synon për Ballkanin Perëndimor paqësor, të begatë dhe demokratik, i cili zhvillohet me vlera europiane dhe kontribuon për sigurinë evropiane. Ne shohim potencialin e jashtëzakonshëm të rajonit dhe në partneritetin e përbashkët me ne. Njëkohësisht, problemet tuaja janë problemet tona. Krimi i organizuar, migracioni i paligjshëm, terrorizmi dhe ekstremizmi në tërësi janë kërcënime që shkojnë përtej kufijve.

Historia na shpalos që stabiliteti dhe siguria e Ballkanit Perëndimor është e rëndësishme edhe për stabilitetin dhe sigurinë e Evropës në tërësi. Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Mbretërisë së Bashkuar në rajon, ne duam që Samiti i Londrës ketë ndikim real në jetën e qytetarëve në Ballkanin Perëndimor. Për këtë arsye, ne do të përqendrohemi në çështje shumë praktike, si korrupsioni dhe krimi i organizuar. Për herë të parë, me këtë rast të gjithë ministrat e brendshëm të rajonit do të jenë së bashku.

Ne duam ta forcojmë bashkëpunimin rajonal në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor. Individualisht, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë në përgjithësi relativisht të vogla. Por duke punuar së bashku për të forcuar lidhjen, për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të mënjanuar barrierat tregtare, ju mund të krijoni një rritje më të shpejtë ekonomike. Ju mund të tërhiqni investime dhe të krijoni vende pune.

Të rinjtë janë pasuria më e madhe e rajonit. Por më tepër duhet bërë për të nxjerrë në

Duke i mirëpritur qeveritë nga Ballkani Perëndimor në Samitin e Londrës, ne gjithmonë do të qëndrojmë pranë atyre që duan ndryshime pozitive. Duke punuar së bashku, ne mund të arrijmë një të ardhme më të mirë për rajonin

pah potencialin e tyre. Samiti i Londrës do të pasqyrojë nisma që do të ndihmojnë sipërmarrësit e rinj, veçanërisht në sektorin digjital dhe do të sigurojnë që brezi i ardhshëm të ketë aftësi për të konkurruar në një ekonomi globale.

Mbretëria e Bashkuar nga përvoja e saj me Irlandën e Veriut e din se sa të vështira dhe dhimbshme mund të jenë këto pyetje. Paqja nuk arrihet automatikisht në fund të konfliktit; përkundrazi duhet të ushqehet brenda shoqërive dhe jashtë kufirit - për të cilën duhet lidhshmëri dhe vizionarë. Pra, duke i mirëpritur qeveritë nga Ballkani Perëndimor në Samitin e Londrës, ne gjithmonë do të qëndrojmë pranë atyre që duan ndryshime pozitive. Duke punuar së bashku, ne mund të arrijmë një të ardhme më të mirë për rajonin.

Njëkohësisht, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe adresimi i konflikteve të trashëguara nga vitet 1990 janë vendimtare për arrijtjen e stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit që të gjithë ne duam ta shohim. Mbretëria e Bashkuar nga përvoja e saj me Irlandën e Veriut e di se sa e vështirë dhe dhimbshme mund të jetë kjo pyetje. Paqja nuk arrihet automatikisht në fund të konfliktit; përkundrazi duhet të ushqehet brenda shoqërive dhe jashtë kufirit - për të cilën duhet lidhshmëri dhe vizionar.

Pra, duke i mirëpritur qeveritë nga Ballkani Perëndimor në Samitin e Londrës, ne gjithmonë do të qëndrojmë pranë atyre që duan ndryshime pozitive. Duke punuar së bashku, ne mund të arrijmë një të ardhme më të mirë për rajonin.

(Sir Alan Duncan është ministër për Europë i Qeverisë së Britanisë së Madhe. Nga mediat në gjuhën shqipe, gazeta KOHA mban të drejtën ekskluzive për botimin e këtij shkrimi)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUR DATON KALAJA E KRUIJËS?

Kalaja e Kruijës është një nga kalatë me të njohura në Shqipëri. Kjo kala me trajtë eliptike dhe me perimetër 804 m, zë një sipërfaqe prej 2.5 ha tokë dhe është ngritur në një kodër shkëmbore.

Gërmimet arkeologjike të vitit 1978 dëshmojnë se kodra ka qenë e banuar që në shek e III p.k. ndërsa kalaja është ngritur në shek. V-VI. Pranë saj është zbuluar një varrezë e

madhe e kulturës arbërore. Përmendet me emrin e sotëm në shek e IX bashkë me qytetin e Kruijës si qendër peshkopale. Në shek XIII-XIV ishte qendra e shtetit të Arbrit. Gjatë periudhës së Skënderbeut u bë kryfortesa e qendresës së shqiptarëve kundër pushtimit osman. Edhe në ditët e sotme njihet një ndër vendet më të njohura dhe më të vizituar nga turistët.

DIMOVSKI REFUZON TA CAKTOJË MBLEDHJEN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJE

ME KSHZ-në, VMRO TENTON TA BLOKOJË REFERENDUMIN

“Derisa partitë nuk pajtohen dhe nuk japin dritë jeshile, nuk mund të thirr seancë të Komisionit për zgjedhje dhe emërim. Në të kundërt, nëse e fillojmë procedurën pa pëlqimin e dhënë nga partitë, procesi nuk do të ketë sukses dhe do të duhet tërë procedura të nisët nga fillimi, me shpallje të re, afat i ri për kandidime që do të humbej kohë shtesë...”, ka thënë Ilija Dimovski



Koha

Evis HALILI

Shkup, 9 korrik - VMRO-DPMNE me strategji të re kundër Referendumit të Qeverisë për ndryshimin e emrit. Komisioni Shtetëror Zgjedhor, institucion ky që duhet të impelementojë procesin e referendumin, mundet që edhe këtë javë të mbetet i bllokuar. Së paku kështu po vepron partia e Hristijan Mickovskit, deputetët e së cilës kanë “ndërruar” fjalët për të mbështetur përzgjedhjen e anëtarëve të KSHZ-së, e cila disa muaj më radhë, ka mbetur me vetëm pa anëtarë. Ndryshe nga optimizmi i kryeministrit Zoran Zaev, se shumë shpejtë do të votohen shtatë anëtarët e KSHZ-së, Ilija Dimovski thotë se nuk e ka ndërmend të thirr mbledhje të Komisionit për zgjedhje dhe emërim për të shqyrtuar kandidataturat e përbërjes së re të KSHZ-së.

“Derisa partitë nuk pajtohen dhe nuk japin dritë jeshile, nuk mund të thirr seancë të Komisionit për zgjedhje dhe emërim. Në të kundërt, nëse e fillojmë procedurën pa pëlqimin e dhënë nga partitë, procesi nuk do të ketë sukses dhe do të duhet tërë procedura të nisët nga filli-

mi, me shpallje të re, afat i ri për kandidime që do të humbej kohë shtesë...”, ka thënë të hënën Dimovski. Madje, Dimovski ka përmendur “marrëveshjen” me LSDM-në në kohën kur VMRO u kthye në Parlament dhe dha mbështetje për ligjet reformuese. Ai ka thënë se fillimisht duhet miratuar Ligji për financimin e partive dhe Ligji për Qeverinë, që më pas të votohen anëtarët e rinj të KSHZ-së.

I menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i LSDM-së. Partia e Zaevit ka akuzuar VMRO-në se qëllimshëm po bllokoi procesin dhe po shtyn përzgjedhjen e KSHZ-së. “VMRO-DPMNE çdo ditë e jep nga një kusht të ri për mbështetjen e negociatave. Me këtë, VMRO-DPMNE qëllimshëm po bllokoi procesin dhe po shtyn përzgjedhjen e KSHZ-së”. Afati për formimin e Komisionit të ri Shtetëror Zgjedhor skadoi më 29 qershor. Përbërja e re do të ketë mandat gjashtëmuor dhe do të jetë e angazhuar për referendumin, të cilin kryeministri Zaev e paralajmëroi për në fund të shtatorit dhe fillim të tetorit të këtij vitit.

Shumica parlamentare tashmë ka vendosur për anëtarët që u takojnë atyre,

ndërsa ka mbetur vetëm VMRO të delegojë emrat në Komision. Kryetari i KSHZ-së, ashtu siç janë marrë vesh dy partitë më të mëdha në vend, do t'i takojë VMRO-së, ndërsa shumica partive në pushtet. Edhe kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, shpreson se opozita nuk do ta bllokojë zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, prej çka varet edhe mbajtja e referendumin.

“Për herë të parë ndodhë që Komisionin për zgjedhje dhe emërim ta udhëheq opozita. Pas përfundimit të vitit 2016, me kompromis u morëm vesh dhe zgjatëm dorë si shumicë, të tregojmë se kemi besim tek opozita. Me gjithë premtimet e opozitës se nuk do shfrytëzohet për obstrukcione ai Komision, shohim se në praktikë nuk është ashtu”, tha ditë më parë Xhaferi në 1TV. Zgjedhja e KSHZ-së nuk mund të kalojë pa pëlqimin dhe votimin e opozitës, duke e pasur parasysh se nevojitet shumicë prej dy të tretave në Parlament. Shpallja për përbërjen e re të KSHZ-së përfundoi para dy javëve, ndërsa janë paraqitur 41 kandidatë. Afati deri kur duhet Parlamenti ta zgjedh përbërjen e re të KSHZ-së është 17 korriku.

LSDM I PËRGJIGJET KËRKESËS SË MICKOVSKIT S'ka amnisti për kriminelët e 27 prillit

Shkup, 9 korrik - Qeveria dhe shumica parlamentare ka hedhur poshtë kërkesën e liderit të opozitës, Hristijan Mickovski, për amnisti të të gjithë të involvuarve në ngjarjet e 27 prillit të vitit të kaluar, kur huliganë maqedonas - të mbështetur nga lëvizja “Për Maqedoni të përbashkët” dhe nga VMRO, sulmuan deputetët dhe demoluan Parlamentin.

Deputeti i LSDM-së, Kostadin Konstandinov, ka thënë të hënën se kriminelët nuk do të shpëtojnë nga drejtësia, ndërsa shumica qeveritare asnjëherë nuk do të pranojë amnistinë e dhunuesve.

“Për VMRO-DPMNE dhe Kristijan Mickovski, nuk janë të rëndësishme as nevojat e qytetarëve dhe as interesat shtetërore. Për ta e rëndësishme është vetëm mbrojtja e kriminit dhe e ardhmja e Nikolla Gruevskit dhe familjes. Prandaj, VMRO-DPMNE shpik kërkesa të re, Qeveri teknike, amnisti dhe të ngjashme. Dëshirojnë të shfaqim krizë artificiale vetëm për t'i shpëtuar kriminelët nga përgjegjësia. Kjo është e vetmja gjë për të cilën lufton Kristijan Mickovski. Një duhet të jetë e qartë, amnisti për krim nuk do të ketë. Asnjëherë nuk do të pranojmë amnisti të kriminelëve”, u shpreh Konstandinov.

Ndryshe, kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickovski, në marshin protestues të dielën në qytetin e Strumicës, tha se të akuzuarit për “terrorizëm” për ngjarjet e vitit të kaluar janë të pafajshëm dhe se i gjithë rasti, sipas tij, është i orkestruar për të frikësuar popullatën si dhe për të luftuar të gjitha ata që nuk mendojnë se pushteti.

“Janë pesë deputetë të VMRO DPMNE-së që ngarkohen për diçka që nuk e kanë bërë gjegjësisht akuzohen për terrorizëm. Asnjëherë mos mendoni se i kam harruar ata vëllezër dhe motrat që tani janë nëpër burgje dhe që janë pjesë e fushatës politike kundër çdo maqedonasi që mendon lirshëm. Për këtë bëjë thirrje për amnisti për personat e ngjarjeve të 27 prillit...Nuk mund të ecim përpara nëse jetojmë në të kaluarën dhe kjo është ajo për të cilën do të luftojmë”, deklaroi Mickovski. (E.H)

Emri, dëshmi se mund të tejkalohen dallimet më të thella

Berlin, 9 korrik - Marrëveshja historike midis Greqisë dhe Maqedonisë për çështjen e emrit tregoi se është e mundur që të tejkalohen edhe dallimet më të thella bilaterale, nëse rritet besimi dhe ekziston vullnet politik, theksoi sekretari shtetëror pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Mihael Roth. Ai në kumtesën, para pjesëmarrjes në mbledhje me ministrat e diplomacive në konferencën e Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit në Londër, theksoi se qëndrueshmëria dhe zhvillimi demokratik i vendeve të rajonit është në interes si për Gjermaninë, ashtu edhe për

Evropën, si dhe ato janë me rëndësi të veçantë për sigurinë e vet. “Mbledhja është një mundësi për vendet e rajonit të përmirësojnë bashkëpunimin rajonal dhe me atë të nxisin përafrimin drejt BE-së”, theksoi Roth. Ai theksoi se në mënyrë që të arrihet rritja e besimit, jo vetëm midis politikanëve, por edhe midis qytetarëve, Qeveria gjermane e mbështet punën e komunitetit rajonal të të rinjve në kuadër të procesit të Berlinit. “Këtu bëhet fjalë për pajtimin e gjeneratave të ardhshme në rajon tek të cilët plagët nga luftërat edhe më tej janë të pranishme”, tha Roth.

Publicitet

KONKURS

Gazeta KOHA shpallë konkurs për:

- dy redaktorë (me përvojë pune)
- katër gazetarë (me përvojë pune)

Kushtet: Kandidatët të kenë të mbaruar arsimin sipëror, si dhe përvojë në redaktim dhe në raportim nga terreni. Përparësi do të kenë kandidatët, të cilët, përpos gjuhës shqipe, zotërojnë edhe ndonjë gjuhë tjetër.

Të interesuarit duhet që CV-të e tyre t'i dërgojnë në e-mail adresën: marketing@koha.com.mk.

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjat deri të mërkurën (11 korrik).

“Nëse marrim ftesën s’do të thotë kjo se në duhet të gëzohemi dhe të qëndrojmë në vend në vend. Na presin shumë punë përpara. Sa i përket referendimit marrja e ftesës nuk lidhte me të, pra është e sigurt se do të marrim ftesë para mbajtjes së referendimit”, tha Radmilla Sheqerinska

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 9 korrik - “Në shërbimin sekret ka persona që e kryejnë punën me profesionalizëm por ka dhe të tillë që e kanë keqpërdorur detyrën. Kur përmendët Zoran Verushevkin po iu them se përmes dëshmime të tij jemi në këtë situatë kur kemi ndryshime të mëdha në shumë aspekte”, kështu e lavdëroi këshilltarin e kryeministrit Zoran Zaev, Zoran Verushevski ministria e Mbrojtjes Radmilla Sheqerinska të hënën gjatë një brifingu me gazetar në prag të samitit të NATOS që do të mbahet më 11 dhe 12 korrik në Bruksel. Në fakt ministria Radmilla Sheqerinska iu shmang pyetjes së gazetës KOHA se pse persona të etiketuar në opinion si të lidhur me rastet e montuara si ai Sopotit dhe raste tjera, siç është Zoran Verushevski dhe persona tjerë që kanë i sjellë problem shtetit në keqpërdorimin e shërbimit sek-

BRIFING ME GAZETARË NË PRAG TË SAMITIT TË NATO-S

SHEQERINSKA: VERUSHEVSKI MË MERITORI PËR NDRYSHIMET QË NDODHËN



ret vazhdojnë të jenë këshilltar të një kryeministri që pretendon të anëtarësojë Maqedoninë në NATO dhe çfarë plani ka Qeveria të ndihmojë në mbylljen e rasteve dilematike për opinionin e ku shqiptarët kanë pësuar me vite burg dhe në fund dolën të pafajshëm.

JO TË GJITHË SIGURISAT DISPONOJNË DOKUMENTE TË KLASIFIKUARA TË NATO-S

Ndërkaq koordinatori nacional për në NATO, Stevo Pendarovski tha se ftesa dhe anëtarësim në NATO nuk nënkupton që secili person që punon në organet e siguri-

së të këtë qasje në dokumente të klasifikuara të NATO-s. “Ju marrë si shembull Kroacinë, e cila edhe pas anëtarësimit të plotë vetëm 30 persona kanë pasur të drejtë të kenë qasje në dokumente të klasifikuara të NATOS duke u pajisur në certifikata të sigurisë. Njëjtë ka qenë edhe me Hungarinë ndërsa më interesant rasti ka qenë më Bullgarinë ku nga të gjithë punonjësit në organet e sigurisë, vetëm një person fillimisht ka pasur qasje në dokumentet e klasifikuara të NATOS”, tha Stevo Pendarovski.

Lidhur me mundësinë që pas marrjes së ftesës, procesi të bl-

lokohe nga ndonjë vend anëtar i NATO-s, ministria Sheqerinska përjashtoi këtë duke thënë se momentalisht të 29 vendet anëtarë janë PRO që Maqedonia të marrë ftesë për në NATO.

“Nëse marrim ftesën s’do të thotë kjo se në duhet të gëzohemi dhe të qëndrojmë në vend në vend. Na presin shumë punë përpara. Sa i përket referendimit marrja e ftesës nuk lidhte me të, pra është e sigurt se do të marrim ftesë para mbajtjes së referendimit”, tha Radmilla Sheqerinska. Sipas saj procedura që nga marrja e ftesës, nga ratifikimi në vendet anëtare dhe deri tek anëtarësimi i

plotë është e njëjtë siç ka ndodhur me vendet tjera, por detyrat prioritare ndryshojnë, p.sh në Mal të Zi tema kryesore pas marrjes së ftesës ka qenë reformimi i organeve të shërbimit sekret, në Shqipëri ka qenë gjyqësori, edhe tek ne mund të jenë po këto tema.

JO AMNISTI PËR SHKAKTARËT E 27 PRILLIT

Ajo përjashtoi mundësinë, pas pyetjes së gazetarëve, se vonesa në konstituimin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor mund të ndikojë në mbajtjen referendimit. Sa i përket kërkesës së VMRO-së për amnisti lidhur me ngjarjet e 17 prillit, Sheqerinska sqaroi se kjo nuk mund të ndodhë për shumë arsye që, siç shtoi ajo, persona që kanë thyer ligjin kundër rendit kushtetues të amnistohen nga përgjegjësia penale.

Aktualisht në Parlamentin grek ka shumicë parlamentare për ta ratifikuar marrëveshjen Shkup-Athinë, njoftoi ministria e Mbrojtjes përkitazi me dilemat e zbatimit të marrëveshjes për emrin në Greqi, duke përmendur me këtë rast edhe përfitimet që mund të ketë Maqedonia nëse bëhet anëtare e NATO-s, duke ndjekë shembujt e vendeve baltike por Shqipërinë.

98 projekte për zhvillimin e zonave më të varfra


Shkup, 9 korrik - 98 projekte për zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara, fshatra dhe zonave me nevoja të veçanta pritet të realizohen gjatë këtij viti. Bëhet fjalë për projekte që do të rrisin cilësinë e jetesës në zonat të pazhvilluara të vendit. Në Qeveri janë nënshkruar të hënën marrëveshjet mes përfaqësuesve të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe Qendrave për zhvillimin e rajoneve planore. Ministri Sulejh Fazliu ka thënë se gjatë përzgjedhjes së projekteve fituese janë përqendruar tek nevojat reale dhe problemet e qytetarëve, ndërsa prioritetet janë konfirmuar përmes një procesi konsultativ. “Për vitin 2018 janë rritur me 50 për qind fondet për zhvillimin e barabartë rajonal. 4,5 milionë euro do të investohen në projektet që i propozuan komunat dhe rajonet planore. Bëhet fjalë për projekte të infrastrukturës ose dokumentacion për projekte më të mëdha, me qëllim që të mundësojmë fonde plotësuese edhe nga donatorë dhe Programi IPA”, ka thënë Fazliu. Për projektet për zhvillimin e barabartë rajonal janë ndarë 196 milionë denarë, pjesa më e madhe e të cilave për rajonin më pak të zhvilluar - Verilindorin dhe më pak para për rajonin e Shkupit. Projektet për zhvillimin e zonave me nevoja specifike do të mbështeten me 56 milionë denarë, ndërsa projektet për zhvillimin e fshatrave me 28 milionë denarë.

XHAFERI TAKOI XHANG ÇINLIN

Projekte reale me Kinën

Shkup, 9 korrik - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, realizoi takim me nënkryetarin e Komitetit Nacional Kinez, Xhang Çingli dhe anëtarët e Delegationit me të cilin marrëdhëniet e ndërsjella të të dy vendeve i vlerësuan si miqësore dhe të bazuara në respekt reciprok. “Vizita realizohet në vit kur shënohen 25 vite prej vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy shteteve dhe kryetari Xhaferi i vlerësoi marrëdhëniet bilaterale si miqësore, të hapura dhe të bazuara mbi respekt të ndërsjellë. Marrëdhëniet e shkëlqyera politike paraqesin bazë të rëndësishme për realizimin e formave më të larta të bashkëpunimit në fushën e shkencës, arsimit, mbrojtjes, bujqësisë, turizmit, shëndetësisë dhe medicinës, kulturës dhe fushave të tjera, njoftoi Kabineti i kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë.

Në raport me Nismën e Varshavës 16+1, Xhaferi tha se është me rëndësi të jashtëzakonshme për projekte reale dhe konkrete që do të kontribuojnë për ndërlidhje më të mirë rajonale dhe bashkëpunim më të madh në drejtim të zhvillimit të përsheptuar ekonomik. Në kuadër



të Nismës, kryetari i Kuvendit informoi për formimin e Këshillit Koordinues të Kulturës në Bibliotekën Universitare Popullore “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup, që ka për qëllim përfundimin dhe pasurimin e bashkëpunimit kulturor ndërmjet 16 shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Republikës Popullore të Kinës. Nënkryetari Çingli i vlerësoi marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve si thellësisht miqësore dhe shprehu kënaqësi që të njëjtat vazhdimisht avancohen nëpërmjet bashkëpunimit në sfera të ndryshme. Ai nënvizoi se qëllimi është që

në të ardhme të shfrytëzohen më shumë potencialet për bashkëpunim ekonomik dhe për këmbim të rritur tregtar. Ai informoi edhe për rritjen mbresëlënëse të ekonomisë kineze dhe për reformat që kontribuuan që Republika Popullore e Kinës të shndërrohet në shtet me prosperitet. Nismën 16+1 për intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit të Republikës Popullore të Kinës me 11 vende anëtare të BE-së dhe 5 vende Ballkanike e vlerësoi si komplementare me bashkëpunimin e Republikës Popullore të Kinës me Bashkimin Evropian.

Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, gjatë prezantimit të rezultateve të 30 ditëve të para të punës, duke folur për ndryshimet në programet mësimore të paralajmëruara të klasave të para, ka bërë me dije se programet do të mbeten të njëjta, pasi nuk do të lejohet të eksperimentohet me nxënësit dhe se nuk do të nisnin të zbatojnë asnjë ide pa qenë të sigurt se janë krijuar kushtet për realizimin me sukses të reformave

MINISTRI ADEMI PËR 30 DITËT

S'KA MË EKSPERIMENTE ME NXËNËSIT



Koha Evis HALILI

Shkup, 9 korrik - Nga shtatori i këtij viti, të gjithë nxënësit e klasave të para do të mësojnë me programe të njëjta. Nuk do të ketë shkolla ku do të pilotohen programet e reja, sipas reformave të paralajmëruara më parë. Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, gjatë prezantimit të rezultateve të 30 ditëve të para të punës ka bërë me dije se nuk do të lejohet të eksperimentohet me nxënësit dhe se nuk do të nisim të zbatojnë asnjë ide pa qenë të sigurt se janë krijuar kushtet për realizimin me sukses të reformave.

"Në këtë kontekst edhe programet e reja për nxënësit e klasave të para do të përpilohen me konsultimin dhe përfshirjen e gjithë faktorëve. Duhet të jemi të kujdesshëm kur marrim vendime, pasi është në pyetje shkollimi i fëmijëve tanë dhe nga cilësia e shkollimit varet e ardhmja e tyre, zhvillimi ekonomik i vendit dhe zhvillimi shoqëror në përgjithësi. Kur bëhet fjalë për zgjidhje të mëdha ligjore, nuk duhet të nxitohet, sepse kemi parë miratime të ligjeve dhe më pas shumë shpejt ndryshime dhe plotësime të atyre ligjeve. Bëhet fjalë për një ligj shumë të rëndësishëm dhe prandaj duhet të gjendet zgjidhja më e mirë. Në lidhje me piloti-

min e planeve, atëherë kur do të mendojmë se një reformë funksionon dhe do të jetë produktive, atë edhe do ta zbatojmë", ka thënë ministri. Grupi i punës në MASH së bashku me ish-ministren Renata Deskovska paralajmëruan ndryshime në programin mësimor të klasave të para, më pak lëndë, më pak orë mësimi..., por sipas ministrit Ademi pas miratimit të ligjit do të mund të flitet për ristë. Sa i takon aktivitetet për arsimin e mesëm MASH po përgatit një ligj të ri për arsimin e mesëm, me theks tek promovimi i arsimit profesional, ndërsa në plan është edhe viti shkollor 2019/2020 që të rumbullakoset procesi i tërë reformimit të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar. Sipas modelit gjerman do të vendoset arsimi i dyfishtë profesional dhe nga shtatori ky koncept do të zbatohet në dy pilot-shkolla, në Ohër dhe në Kavadar. Lidhur me arsimin profesional, këtë muaj filloi im-

Një tjetër risi është vendimi për mësimin e gjuhës italiane nga shtatori i këtij viti si gjuhë e dytë e huaj, ndërsa gjuha boshnjake nga viti i ri shkollor do të jetë lëndë në arsimin fillor nëntëvjeçar. Ministri ka kërkuar nga institucionet e arsimit të latë që statutet dhe aktet e tyre t'i harmonizojnë me Ligjin e ri për arsimin e lartë

plementimi i projektit "Arsimim për punësim në Maqedoni", i financuar nga Ambasada e Zvicrës në vlerë prej 12 milion euro që do të zbatohet në 10 vitet e ardhshme, ku do të përfshihen të rinjtë e papunë dhe atë që janë punësuar

në vende pune joadekuate të moshës deri 29 vjet.

Sa u takon teksteve shkollore ministri Ademi ka bërë me dije se janë formuar komisione për ndryshime deri në 30 për qind të përmbajtjes të shumë librave nga arsimit fillor dhe i mesëm. Një tjetër risi është vendimi për mësimin e gjuhës italiane nga shtatori i këtij viti si gjuhë e dytë e huaj, ndërsa gjuha boshnjake nga viti i ri shkollor do të jetë lëndë në arsimin fillor nëntëvjeçar. Ministri ka kërkuar nga institucionet e arsimit të latë që statutet dhe aktet e tyre t'i harmonizojnë me Ligjin e ri për arsimin e lartë, me qëllim që të përmirësohet vazhdimisht korniza aktuale ligjore në sferën e arsimit. Një prej arritjeve të kësaj periudhe është Ligji për përkrahjen e të rinjve gjatë bërjes së instrumenteve muzikore, me të cilin MASH participon për të ulur koston e instrumenteve që duhet të blejnë nxënësit dhe studentët e rregullt.

KRONIKË

Akoma në rrezik jete foshnja e rrahur rëndë

Gjendja shëndetësore e foshnjës 14-muajshe, e cila me lëndime në trup para dy ditësh u çua në Qendrën e Urgjencës nga nëna e saj, është relativisht stabile, informojnë për MIA-na nga Klinika e Anesteziologjisë, Reanimacionit dhe Mjekimit Intensiv (KARIL). Nga Klinika theksojnë se foshnja merr frymë në mënyrë të pavarur dhe nuk është në aparate, por ende është në rrezik për jetën. Ajo ka edhe thyerje në pjesën e poshtme të këmbëve. Ndërkohë vazhdon hetimi policor që të konfirmohet se cili e ka rrahur foshnjën 14-muajshe.

Plaçkitet një bastore në Tetovë

Të dielën mbrëma rreth orës 21.00, deri më tani një person i panjohur - i maskuar dhe i armatosur me armë zjarri, ka kryer plaçkitje në një bastore sportive në rrugën e "Ilindenit" në Tetovë, pronë e 38 vjeçarit E.M nga Tetova. Sipas policisë, personi i panjohur ka hyrë në objekt, ku ka qenë vetëm e punësuar, duke e kërcënuar me armë, nga sirtari në arkë ka marrë 12.420 denar, si dhe 2000 denarë të cilat e punësuar i ka pasur në çantën e saj. Me paratë e vjedhura si dhe çelësin e arkës menjëherë është larguar nga bastorja, dhe me biçikletë është larguar nga vendi. Po merren të gjitha masat dhe aktivitetet, për zbardhjen e plotë të rastit dhe për zbulimin e plaçkitësit

Afër Vardarit gjendet mjet shpërthyes

46 vjeçari H.I. nga fshati Nerashit i Komunës së Tearcës, të dielën rreth orës 18.00 ka denoncuar se duke peshkuar në lumin Vardar, përgjatë rrugës lokale Jazhincë-Radushë, së bashkë me shokun e tij kanë gjetur mjet shpërthyes. Janë kryer hetimet në tërësi, ndërsa bëhet fjalë për raketahedhës RPG-7, e cila dukshëm ka qenë e ndryshkur në pjesët sipërfaqësore. Raketa është fotodokumentuar, është marrë nga vendi, dhe në mënyrë të sigurt është transportuar nga ana e pjesëtarëve të drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim.

Vdes 21-vjeçari që u sulmua në Autokomandë

Shkup, 9 qershor - Dje në mëngjes në orën 8:00 vdiq N.S (21) i cili më datën 29 qershor fizikisht u sulmua nga ana e tre personave më stacionin e autobusit në bulevardin "Aleksandar Makedonski". Më 30 qershor, Ministria e Punëve të Brendshme kumtoi, se më 29 qershor, rreth orës 17:30 është sulmuar fizikisht N.S nga ana e tre personave të panjohur. Pas sulmit fizik, personat me automjetin e kanë braktisur vendin e ngjarjes, ndërsa N.S me automjet të

Ndihmës së Shpejtë në gjendje jokompaktibile është transferuar në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza". Pas incidentit, dy të rinj shqiptarë janë arrestuar në Stacionin Policorë Kisela Vodë për shkak dyshimit se janë kryerës të mundur të veprës penale. Më 2 korrik, Sektori i Punëve të Brendshme Shkup parashitri padi penale kundër B.B (20), S.D (21) dhe J.L (19), të gjithë nga Shkupi për veprë të kryer penale "dhunë". Megjithatë, tani pas vdekjes së 21-vjeçarit, ekzistojnë

mundësi të mëdha që vepra "dhunë" të riakualifikohet në "dhunë me pasojë vdekje". Megjithatë, zëdhënësi i MPB-së, Toni Angellovski, tha se nuk është puna e tyre si polici të merret me mundësitë për rikualifikimin e veprës, pasi këtë vlerësim duhet ta bëjë prokuroria. Pas disa mobilizimeve në rrjetet sociale nga grupi i tifozëve "Komitët" për të marrë hakun e djalit që poashtu kishte qenë pjesë e "Komitëve", Angellovski apeloj për qetësi pasi siç tha, kri-

mineli ose dhunuesit nuk ka as etnitet as fe dhe e asnjë identifikim tjetër. "Nuk duhet shikuar me prapavijë politike. Në të kaluarën kjo tentohej të futet në bisedë. Dhunuesi është dhunues. U bëj apel të gjithëve që shkruani që dhunuesin ta përjetojnë si dhunues. Nuk ka rëndësi a është shqiptar ose maqedonas. Ai që është dhunues do të japë llogari pasi drejtësia funksionin. Të dyshuarit janë në paraburgim. Nuk kanë ku të ikin", deklaroi Angellovski.

Vërejtjet dhe rekomandimet që sektori civil dhe qytetarët i adresojnë institucioneve shtetërore në përgjithësi, Qeveria nuk do t'i anashkaloj. Gjatë prezantimi të Planit nacional aksionar "Partneritet i hapur qeveritar 2018-2020", nën patronatin e MSHIA-as, u tha se organizatat joqeveritare luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve demokratike të organeve shtetërore

Koha

Omer XHAHERI

Shkup, 9 korrik - Qeveria e Maqedonisë dhe institucionet shtetërore janë të interesuar në përforsimin e bashkëpunimit me sektorin civil. Zëvendësministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Aleksandar Bajdevski, të hënën u shpreh se qëllimi kryesor i projektit "Partneritet i hapur qeveritar 2018-2020", është komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me qytetarët. Organizatat joqeveritare në vend, sipas tij, akumulojnë energji të lartë të kreativitetit, të cilën nëse institucionet nuk e pranojnë dhe nuk e shqyrtojnë gjatë krijimit të politikave të reja, mund të humbin shumë. Planin nacional-aksionar i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) përfshin një sërë aktivitete të cilat Qeveria, pritet ti ndërmerr gjatë dy viteve të ardhshme, me të vetmin qëllim përforsimin dhe thellimin e transparencës dhe efikasitetit.

TRANSPARENCA PRIORITET I QEVERISË

SEKTORI CIVIL, ALEAT I ORGANEVE SHTETËRORE



"Deri në 2020, institucionet shtetërore do të bëjnë përpjekje në avancimin e parimit të transparencës në më shumë sfera, duke filluar nga qasja e lirë e informacioneve, avancimin e mekanizmave për përcjellje të gjendjes pronësore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Tutje synohet avancimi i transparencës në përpilimin e programeve shëndetësore, rritjen e vetëdijes për të dhënat e hapura. Transparenca në nivel lokal, po ashtu është prioritet i Qeverisë, me çka gjatë dy viteve të ardhshme pritet të krijohen vegla të reja për përmirësimin e transparencës financiare të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe shërbimeve publike që i ofrojnë ata. Dhe, dy sektorët e fundit që do të punohet në rritjen e transparencës janë drejtësia, gjegjësisht

qasje e grupeve të marginalizuara deri te e drejta e mbrojtjes dhe përmirësimi i njohurive kolektive për ndryshimet klimatike", tha zëvendësministri Bajdevski.

Planin gjithëpërfshirës i Qeverisë për rritjen e transparencës në organet shtetërore, njëkohësisht mendon ti afrohet mes vete qytetarët dhe institucionet shtetërore. Përfaqësuesit e MSHIA-së, theksuan se ky projekt e vërteton tezën se suksesi i Qeverisë varet nga afërsia dhe transparenca ndaj qytetarëve, respektivisht vërejtjeve dhe kritikave që vijnë nga sektori civil. "Përpjekjet e Qeverisë gjatë vitit të kaluar u realizuan pikërisht në këtë drejtim. Hulumtimi i fundit i realizuar nga Bashkimi Evropian, ka konstatuar se Qeveria e Maqedonisë, është e para në rajon sa i përket transparencës

dhe llogaridhënies. Përderisa në analizën e vitit të kaluar, kur flasim për çështjen e afërsisë së institucioneve me qytetarët, vendi ynë ishte në vendin e 6 në rajon. Kritikën dhe kontributin të cilën sektori civil e dha vitin e kaluar, padyshim se ishte një ndihmë e madhe që Qeverinë tonë e renditi në vendin e parë ndër shtet e Ballkanit për transparencë dhe llogaridhënie", nënvizoi zëvendësministri, Bajdevski.

Cvetanka Ivanova, sekretare gjenerale e Parlamentit të Maqedonisë, në fjalimin e saj para të pranishmëve, potencoi se sektori civil pas asnjë fije dyshimi në një shtet demokratik është pushteti i katërt. Pa organizatat joqeveritare e ajo u shpreh e bindur se shumë është rëndë të arrihet një vendim të mirëfilltë publik, respektivisht në mungesë

të këtyre organizatave një shoqëri e ka vështirë të kuptoj se çka (nuk) duhet të ndryshohet në një shtet.

"Ky projekt është tepër i rëndësishëm për ne si Parlament, për shkak se sidomos gjatë vitit 2017 ne si institucione në mënyrë aktive kemi kyçur në projektin e organeve të hapura shtetërore dhe më të vërtet ne po japim maksimumin që kjo nisim të ketë sukses. Pavarësisht faktit se Parlamenti është i hapur për qytetarët ne vlerësojmë se në të ardhmen duhet të bëhen përpjekje që transparenca të rritet edhe më tepër. Para nesh është një plan ambicioz për të krijimin e demokracisë funksional në vendin tonë. Në periudhën një vijon grupi i krijuar në kuadër të parlamentit për zbatimin e këtij projekti do të përqendrohet në zbatimin e tre pikave (përpjekjeve). Fillimisht përgjegjësia dhe llogaridhënie janë sferat ku ne do të fokusimi me aktivitet tona, pastaj renditen teknologjia informatike dhe përfshirja e qytetarëve në procesin mbikëqyrës dhe ligjvënës", tha Ivanova, sekretare e Parlamentit. Ndryshe, përkundër premtimeve dhe paralajmërimeve se Qeveria dhe institucionet shtetërore do ta rrisin transparençën e organeve shtetërore, mediat dhe opinionin më i gjerë vazhdon të hasin në pengesa dhe barrierat të ndryshme gjatë tentimit për të marrë informacione nga organet gjyqësor (prokurorit dhe gjykatat).

ZYRTARËT E MINISTRIVE NË TERREN

KOMUNAT NJIHEN ME MASAT PËR ZHVILLIM RURAL

Shkup, 9 korrik - Komuna e Likovës ishte e para që të dielën u vizitua nga përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe dikastereve të tjera me qëllim të njoftohen zyrtarët e vetëqeverisjes lokale me mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve IPARD, si dhe të ofrohet mbështetje për zbatimin e projekteve të tjera. Vizita të ngjashme do të pasojnë edhe në komunat e tjera në Maqedoninë perëndimore. Sipas sekretarit shtetëror në Ministrinë e Bujqësisë, Nefruz Çeliku, qëllimi i këtyre takimeve është që komunat të njihen nga afër me masat e ndryshme të Programit për zhvillim rural të dedikuara për zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës komunale dhe rrugore në komunat



rurale, kohëzgjatjen e afateve për aplikim, kushtet e aplikimit e kështu me radhë.

"Këto takime janë mjaft të dobishme për shkak se mundësojnë që nga afër të qartësohen të gjitha dilemat eventuale se si komunat të arrijnë më lehtë deri tek këto

mjetet si dhe t'u ofrohet atyre ndihmesë gjatë përgatitjes së aplikimeve etj. Gjithashtu, ato kanë një vlerë të madhe, për shkak se diskutohen në teren edhe problemet e ndryshme të fermerëve, si dhe ofrojnë mundësinë që Ministria e Bujqësisë të ndihmojë bujqit në zgjidhjen

e halleve dhe problemeve të tyre", theksoi Çeliku. Ndryshe, nga Ministria e Bujqësisë theksojnë se deri në fund të muajit gusht, komunat do të mund të konkurrojnë për tre masa të dedikuara për ruajtjen e vlerave natyrore dhe kulturore në viset rurale. Aplikuesit me masën 321 për përmirësimin cilësisë së jetesës në mjediset rurale do të mund të shfrytëzojnë mjetet për ndërtimin e kanalizimeve, lidhjen e rrugës me rrugën lokale apo rajonale në gjatësi prej 5 deri 7 kilometra, ndërtimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin dhe rinovimin e qendrave rinore kulturore, tregut të kafshëve etj.

Me masën 322 - Rinovimi dhe zhvillimi i fshatrave, aplikuesit do

të mund të fitojnë mjete për rikonstruimin apo ndërtimin e planeve të detajuara urbanistike, rikonstruimin apo ndërtimin e shesheve. Me masën 323 - Ruajtje dhe avancim i vlerave tradicionale në rajonet rurale, aplikuesit do të mund të ndërtojnë rrugë për lidhjen me objektet kulturore apo objektet që kanë rëndësi jetike për qytetarët, si dhe lidhjen infrastrukturore me objektet e trashëgimisë kulturore, rregullimin e vendeve për piknik, gjelbërimin e hapësirave përreth liqeve natyrore apo rrugëve magjistrale në mjediset rurale. Një komunë mund të fitojë më së shumti deri në 55 milion denarë për tre masat e ndryshme të zhvillimit rural. (F.P)

Në maj 222 leje për ndërtim, 477 banesa të reja

Shkup, 6 maj - Në maj të këtij viti janë lëshuar 222 leje për ndërtim, që është për 7,9 për qind më pak në krahasim me majin e vitit të kaluar. Në periudhën e raportimit është paraparë ndërtimi i 477 banesave, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzimit prej 38.951 metër katrorë, publikoi sot Enti Shtetëror i Statistikës. Më shumë leje janë lëshuar në rajonin e Shkupit, 40, ku kryesojnë komunat Qend[ur, Butel dhe Shuto Orizarë, me nga nëntë leje. Vijon rajoni jugperëndimor me 39 leje, prej të cilave 20 janë në Kërçovë. Edhe në Strumicë janë lëshuar 20 leje për ndërtim, të cilat janë pjesë e 36 lejeve të lëshuara. Më pak leje për ndërtim, katër, ka në rajonin verilindor. Sipas lejeve të lëshuara për ndërtim, vlera e paraparë e objekteve është 3.529.344.000 denarë, që është për 4,2 për qind më pak në krahasim të majit të vitit të kaluar. Nga numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara për ndërtim, 16 (52,2 për qind) janë dedikuar për objekte të ndërtimit të lartë, 41 (18,5 për qind) të ndërtimit të ulët dhe 65 (29,3 për qind) për objekte për rikonstruktim. të 116 (52,3 për qind) objekte si investues paraqiten persona fizikë, ndërsa të 106 (47,7 për qind) investues janë subjekte afariste. (mia.mk)

Boshkovski do të dëshmojë te "Tortura"

Shkup, 9 korrik - Me dëshmimin e Lube Boshkovskit më 3 shtator do të vazhdojë seanca për lëndën "Tortura" e Prokurorisë speciale publike, ku janë akuzuar ish drejtori i DSK, Sasho Mijalkov, ish njeriu i parë i njësisë "Alfa" Ivica Anteski - Puki dhe pesë pjesëtarë të njësisë, për arrestimin e Boshkovskit. Në fjalët e para, prokurori Ljubomir Lape sot tha se PSP-ja do të dëshmojë se në bazë të përcaktimit politik, i akuzuari i parë Sasho Mijalkov i ka detyruar të akuzuarit tjerë që gjatë arrestimit të Boshkovskit, ai të vuajë shpirtërisht, e tërë kjo për shkak të hakmarrjes politike për porositë e marra gjatë fushatës zgjedhore. Sipas Lapes, policët në kundërshtim me dispozitën për mjete për detyrim me dhunë, kanë përdorur fuqi tejmasë. Policët, tha ai, e kanë dëgjuar urdhrin dhe e kanë transmetuar kërcënimet e Mijalkovit, ndërsa njëri nga të akuzuarit i ka vënë pistoletë në kokë dhe i ka thënë "nuk do të shohish ditë të bardhë". Si dëshmi, prokurori Lape tha se do të parashtrohen incizime nga disa televizione dhe video xhirime nga MPB-ja nga dita e arrestimit, si dhe dëshmitë me shkrim të mbështetura nga të a.q. bomba. "Pasoja nga arrestimi, respektivisht vuajtja shpirtërore do të dëshmohet me dokumentacion mjekësor", tha Lape. Mbrojtësi i Mijalkovit dhe një pjesë e të akuzuarve, Petar Vasilev iu referua amnistisë së presidentit Ivanov dhe propozoi lirim nga përgjegjësia penale për të akuzuarit. Ai tha se nëse gjykata vazhdojë ta udhëheq këtë lëndë, do të shkel Ligjin dhe do ta dëmtojë buxhetin e RM-së. Të gjithë të akuzuarit para gjykatës u prononcuan se nuk janë fajtorë. (O.Xh)

SHËNDETËSIA FALAS PËR TË GJITHË QYTETARËT

A DO TË PËSOJË CILËSIA E SHËRBIMEVE?

Përvojat botërore, si dhe hulumtimet e kryera nga ekspertët e Heltgrup sugjerojnë se një masë e tillë mund të rezultojë në efekte krejtësisht të kundërta sesa pritjet. Në veçanti, participimet janë një mekanizëm që synon të kufizojë trajtimin e tepruar (dhe shpesh jo të nevojshëm) në spitale

Koha

Delvina KËRLUKU

Shkup, 9 korrik - Reformat në shëndetësi nga qeveria e re kanë nisur mbarë. Këtë e ka bërë të ditur kryeministri Zoran Zaev, por edhe ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe. Të dy kërret kanë paralajmëruar se nga 1 janari i viti 2019 do të ketë trajtim falas në spital për të gjithë qytetarët. Deri më tani, ky trajtim ishte vetëm për fëmijët e pranuesve të asistencës sociale, dhuruesit të gjakut dhe disa kategori të tjera të pacientëve. Raporti i Fondit për siguri shëndetësore për vitin 2017 tregon që, në lidhje me participimet janë harxhuar 436.608.000 milion denarë. Në 2016 kjo shumë ka arritur 415.020.000 milionë denarë. Mjekët dhe drejtorët e spitaleve (nuk dëshirojnë që publikisht ta komentojnë informatën e lirimimit nga participimi), thonë se për afat të gjatë mund të ndikojë negativisht në sistemin shëndetësor. Mund të vihet në pyetje stabiliteti financiar i spitaleve, përderisa nuk do të merren paratë në kohë që tani janë mbledhur nga participimi, ndërsa mund të rritet edhe lista e pritjes së operacioneve. Për operacionet që nuk llogariten si urgjente, ajo e (fshikëz) tëmthit, ku tani pritet për një vit, por edhe më shumë.

ÇFARË DO TË JENË PASOJAT?

Se sa këto premtime do të realizohen, a ka Maqedonia mundësi atë ta realizojë, çfarë do të jenë pasojat dhe cilat janë efektet e pritura në këtë hap të ndërmarë, do të tregojë koha, thotë eksperti i Shëndetësisë Vlladimir Llazareviq. Ai sqaron se participimi është futur nëpër botë për disa arsye bazike, e para që të ketë kontroll në lidhje me numrin e madh të shëruesve, ndërsa arsyeja e dytë është të sigurohet mjetet plotësuese, të cilat do të shkojnë drejtpërdrejtë të dhuruesit i shërbimeve. Sipas Llazareviq, participimi është mekanizëm kontrollues, instrument përmes së cilit konsumatori i shërbimeve shëndetësore mund të përfshihet mbi abuzimet e mundshme, të tilla si përdorimi i tepruar i shërbimeve shëndetësore, hospitalizimi i tepruar dhe të ngjashme. Sipas doktor Llazareviq,



RRITEN TË ARDHURAT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Shuma e caktuar e së drejtës për një pagesë të posaçme me ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve rritet nga 4202 denarë në 5021 denarë. Gjithashtu, prindërit e vetëm që kanë një fëmijë me nevoja të veçanta me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, ose aftësi të kufizuara të shumëfishta deri në 26 vjet - në vend të 6303 denarëve, do të marrë shumën e 7351 denarë. Për prindërit që s'kanë siguruar mjete financiare, e të cilët janë përfitues të ndihmës sociale dhe vazhdimisht marrin ndihmë financiare dhe që kanë një fëmijë me nevoja të veçanta deri në 26 vjet, të ardhurat shtesë rriten prej 5252 denarë rriten në 6276 denarë. Këto ndryshime janë vetëm pjesë e strategjisë së Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për të përmirësuar gjendjen financiare dhe kushtet e jetesës së grupeve më të prekshme të qytetarëve.

kjo iniciativë e Qeverisë është populiste, e dizajnuar për të krijuar mbështetje në mesin e njerëzve dhe nuk ka të bëjë fare me reformën e kujdesit shëndetësor. Për të qenë e qëndrueshme, Qeveria duhet të ofrojë një mënyrë për të plotësuar fondet e humbura dhe si të përballet me nevojën për rritje.

Mirëpo, kryeministri Zaev, thekson se me rebalancin e buxhetit do të sigurohen 7,8 milion euro, me qëllim që pacientët të jenë të liruar nga participimi. Nga Qeveria këmbëngulin se shërimi pa pagesë i të sëmurëve është pjesë e programit të tyre.

Me heqjen e participimit, respektivisht trajtimin falas të pacientëve, në spitale do të rriten listat e pritjes në spitalet shtetërore, të cilat do të detyrojnë pacientët të trajtohen më shumë në kujdesin shëndetësor privat.

MASA QË STIMULOJNË SEKTORIN PRIVAT

Spitalet private do të përfitojnë nga masa e propozuar. Kjo do të thotë se rritja e kërkesës për shërbime do të hapë mundësi të reja të tregut për sektorin privat për të rritur çmimet e shërbimeve që ofron. Në këtë mënyrë, rezultati i drejtpërdrejtë i heqjes së participimit do të ndikojë në xhepat e qytetarëve në 12-24 muajt e ardhshëm, thonë analizat nga Heltgrup, një organizatë që po shqyrton situatën shëndetësore në Evropën Juglindore.

Përvojat botërore, si dhe hulumtimet e kryera nga ekspertët e Heltgrup sugjerojnë se një masë e tillë mund të rezultojë në efekte krejtësisht të kundërta sesa pritjet. Në veçanti, participimet janë një mekanizëm që synon të kufizojë trajtimin e tepruar (dhe shpesh jo të nevojshëm) në spitale. Kjo masë paraqitet në të gjithë botën dhe përdoret edhe nga vendet më të pasura, si Gjermania, Japonia, Shtetet e Bashkuara dhe të tjerët. Kur të hiqen tarifat e pjesëmarrjes, automatikisht pritet të rritet kërkesa për shërbimet shëndetësore dhe kjo do të ndikojë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Situata e re do të detyrojë "furnitorët" më saktë spitalet për arsye që nuk mund t'i përgjigjen kërkesës në rritje për të futur masat e tyre kufizuese në formën e kohëzgjatjes së pritjes për trajtim. Hulumtimet e mëparshme nga Heltgrup kanë dokumentuar se një nga arsyet kryesore përse pacientët vendosin të trajtohen në spitalet private është shkurtimi i kohës së pritjes.

Heltgrup i kërkon Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të rishqyrtojnë këtë vendim me qëllim që të parandalojnë efektet e dëmshme afatgjate në sistemin shëndetësor. Ata shprehen të gatshëm të zhvillojnë analiza shtesë që do të ndihmojnë autoritetet shëndetësore në marrjen e vendimit përfundimtar.

Ndryshimet globale klimaterike e ndryshuan edhe strukturën e kultivuesve të kulturave bujqësore në fushën e Strumicës. Më nuk prodhohen llojet e dikurshme të specave, por zëvendësohen me më të qëndrueshme, por që nuk kanë shije tamam speci. Kështu po ndodhë edhe me domatet hibride...

Strumicë, 9 korrik - Një prej kopshteve të perimeve në Gadishullin Ballkanik - Strumica po ballafaqohet me prodhimtari të zvogëluar. Prej të gjitha kulturave kopshtare, vetëm lakra nuk ka dështuar në prodhim, ndërkaq domatet, trangujt, specat dhe kulturat e tjera në sipërfaqe të hapura dhe nën sera në mënyrë drastike po dështojnë në prodhim. Sipas ekspertëve bujqësorë, ndikim më të madh ndaj uljes të prodhimeve bujqësore kanë ndryshimet klimaterike, të cilat nuk po e anashkalojnë edhe Maqedoninë, ndërsa në rajonin e Strumicës manifestohet me mikro-ndryshime klimatike.

"Jemi dëshmitarë se çdo vit, ndërsa posaçërisht këtë vit, nga fillimi i pranverës, kemi ndryshime të papritura në kushtet e motit, Kjo posaçërisht është e dukshme nga amplitudat e mëdha të temperaturës mes ditës dhe natës. Kemi gjendje të çuditshme meteorologjike në të cilën temperaturat gjatë natës dhe në mëngjes janë shumë të ulëta, ndërsa gjatë ditës rriten edhe mbi 30 gradë celsius. Kur tërë kësaj do t'i shtohen edhe reshjet intensive të shiut, të shoqëruar me breshër, atëherë dëmet janë më të mëdha", thotë dr. Risto Vuçkov, ekspert për mbrojtje të bimëve. Ai shton se në shumë rajone në vend, dëmet janë të mëdha, posaçërisht të mbjellat afatgjate të pemëtarisë. Breshëri ka shkakuar dëme aq të mëdha që prodhuesit nuk kanë mundësi të fitojnë rendimente as vitin e ardhshëm. Edhe te kulturat kopshtare gjendja gjithashtu është e keqe.

KLIMA PO ZBRAZ XHEPIN E BUJQVE

"Dallimet e temperaturave në fazën e lulëzimit dhe formimit të frutave, si dhe reshjet e rrëmbyeshme, posaçërisht te lloji i specit i njohur si 'ajvarka' prej të cilit priten rendimente të mëdha, shkaktoi dëme të mëdha", shton dr. Risto Vuçkov. Sipas tij, dëme do të ketë te kulturat e drithërave. Në fazën kur duhet të korret, autokombanja nuk mund të hyjë në fusha, ndërsa klasa e pjekur për shkak të lagështisë së madhe bie dhe një pjese nga rendimenti mund të përfundojë në tokë.

"Kushtet e këqija dhe të paparashikueshme ndikojnë bimët ta humbin rezistencën ndaj së-

SPECAT DHE DOMATET PO ZHDUKEN

NDRYSHIMET KLIMATIKE PO ZBRAZIN XHEPAT E BUJQVE



mundjeve dhe për këtë sëmundja 'bastër' paraqitet në vende ku ka dëme të mëdha të të mbjelljeve", paraqiten edhe sëmundje të tjera, të cilat shkaktojnë dëme të mëdha, vlerëson dr. Risto Vuçkov, ekspert për mbrojtje të bimëve. Pasojat prej ndryshimeve klimaterike bujqit më së shumti i ndejnë në xhepin e tyre.

"Për dallim prej më parë tani i kushtojmë më shumë vëmendje mbrojtjes dhe jemi duke harxhuar për blerjen e preparateve më të ndryshme. Për zbatimin e tyre rralë konsultohemi me persona profesionistë apo zgjedhjen e lëmë ta bëjnë farmacitë bujqësore", thonë bujqit nga Strumica. Ndryshimet globale klimaterike e ndryshuan edhe strukturën e kultivuesve të kulturave bujqësore në fushën e Strumicës. Më nuk prodhohen llojet e dikurshme të specave, por zëvendësohen me më të qëndrueshme. "Më parë, speci i llojit 'medalja e artë' kultivohej në hapësira të hapura. Tani ndryshimet klimaterike nuk lejojnë të mbillet në hapësirë të hapur. Specat nuk do të rriten ose aspak nuk do të japin frutat dhe prandaj ky lloj speci nuk mbillet. Tani shkohet me disa hibride, por ato nuk e kanë shihen e 'medaljes së artë', thonë më shumë prodhues të specave në Strumicë. Sipas Danail

Pallankov, bujk nga fshati Murtinë-është mirë që speci i njohur si "ajvarka" arriti të shpëtojë nga zhdukja dhe filloi të mbillet në serra. Ai shumë pak mbillet në hapësira të hapura, edhe pse ndryshimet klimaterike më së shumti e godasin atë. "Duhet të jesh mjeshër i vërtetë për të prodhuar spec në hapësira të hapura dhe duhet bujku të jetë i kënaqur nëse arrin të ketë rekoltë prej 2-3 tonë prej një hektari", vlerëson Pallankov. Ekspertët janë të qëndrimtë se ndryshimet globale dhe klimatike krijojnë sëmundje të reja tek kulturat bujqësore, të cilat deri më tani janë pak të njohura për shkencën. Nga ajo nuk është immune as prodhimtaria bujqësore e Maqedonisë, e cila në vitet e fundit i është ekspozuar sëmundjeve të reja.

Krahas asaj, prodhuesit bujqësor nuk janë të edukuar se si ta ulin përdorimin e pesticideve, sa kohë duhet të kalojë nga spërkatja e fundit deri në vjelje, si të ulet përdorimi i pasigurt i plehrave minerale dhe të përfitohen njohuritë themelore për prodhimtarinë. Gjithsesi në të rol të madh kanë edhe institucionet të cilat duhet t'u ndihmojnë bujqve, por ato shumë pak janë të pranishme në terren. "Nuk ka terren ku sëmundjet e reja nuk janë të pranishme. Por, studimet e tyre janë në

fillim dhe mendoj se nëse u kushtohet vëmendje më e madhe në kohë të afërt do të shkaktojnë dëme akoma më të mëdha në prodhimtarinë tonë bujqësore", konsideron dr. Risto Vuçkov, ekspert për mbrojtje të bimëve.

Bujqit ende kanë mëdyshje se si t'u kundërvihen ndryshimeve klimatike-nëse me zbatim të masave të reja agroteknike apo t'i ndryshojnë kulturat dhe të kalojnë në ndonjë lloj të ri të prodhimit, më rezistues ndaj ndryshimeve të papritshme klimatike. "Duhet të mendojmë se si t'i amortizojmë efektet nga ndryshimet klimatike. Nëse do ta bëjmë atë me hijesimin e të mbjellave, vendosjen e rrjeteve dhe ndjekjen e kushteve atmosferike, përkatësisht braktisjen e mënyrës së deritanishme të punës dhe prodhimin apo ndërkaq të fillojmë të kultivojmë kultura të tjera të cilat janë ekzistente ndaj ndryshimeve klimatike", thotë Risto Vellkov, bujk nga fshati Vasilevë. Mendimin e tij e ndan edhe Danail Pallankov, i cili konsideron se jo vetëm bujqit, por edhe shteti duhet të mendojë seriozisht si të mbrohet prodhimtaria bujqësore nga ndryshimet klimatike.

"Nëse do të mendohet për vendosje të rrjeteve apo serrave në

sipërfaqet e hapura apo do të zbatohet ndonjë teknologji e re varësisht nga ne, por edhe nga institucionet kompetente. Krahas kësaj, duhet të kthehen në përdorim raketat kundër breshrit dhe shteti të mendojë për themelimin të ndonjë fondi për mbrojtje të të mbjellave", konsideron Pallankov.

NDRYSHIMET KLIMATIKE E "HANË" EDHE BUXHETIN

Për vitin 2017, nga buxheti i Maqedonisë janë paguar rreth 4.5 milionë euro për dëmet e shkaktuara nga moti i keq dhe janë parashtruar 17.800 kërkesa. Ministri i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave, Lupço Nikollovski, gjatë vizitës së tij para disa kohëve në rajonin e Strumicës, theksoi se sigurimi i prodhimeve bujqësore është një temë e veçantë në të cilën Ministria është e fokusuar dhe ka strategji afatmesëm dhe afatgjatë, e cila është prezantuar para bujqve dhe kompanive të sigurimeve.

Nikollovski tha se Qeveria përmes kompanisë të risigurimit "Evropa Ere", e cila është formuar në shkallë rajonale, ndërsa në të cilën Qeveria ka një investim themelor, nga vitit i ardhshëm do të përdoren instrumentet financiare të kësaj përkatësie plotësuese e cila do të vijë përmes kësaj kompanie të risigurimit. "Kjo nënkupton se bujqit do të marrin një dëmshpërblim shtesë në të gjitha rajonet ku rendimenti do të bjerë nën kufirin e caktuar. Masa e tretë e cila shqyrtohet është vendosja e një qendre kompjuterike krejtësisht të re dhe të automatizuar dhe hartimi i të gjitha pikave në vend ku duhet që të instalohen pajisje kundër breshrit", shtoi ministri Nikollovski. Sipas tij, ekspertët kanë locuar gjithsej 181 pika ku duhet që të ketë të tilla sisteme dhe dokumentacioni teknik për këtë është përgatitur. Paralelisht me këtë nga ana e ministrisë dikasteriale janë instaluar tre stacione agrometeorologjike në Strumicë, Koçan dhe Gradsko, ndërsa vitin e ardhshëm do të rritet numri i tyre.

Ministri rikujtoi se ka përfunduar riparimi i Sistemit të radarëve në Gjurište dhe së bashku me sistemin në Topollçani përmes aplikimit celular të gjithë bujqve do t'i jepet parashikimi i saktë i gjendjes së motit. Në vitet e kaluara në Rajonin e Strumicës në vit prodhohen mbi 250 milionë kilogramë prodhime të ndryshme bujqësore. Sipas bujqve, sivjet prodhimi i përgjithshëm është ulur midis 30 dhe 40 për qind në krahasim me vjet dhe vitet e kaluara. (mia.mk)

RRITEN SHPENZIMET PËR JETESË

Shpenzimet për jetesë në qershor janë të pandryshuara në krahasim me muajin e kaluar, ndërsa lidhur me qershorin e vitit të kaluar shënojnë rritje prej 1.4 për qind, publikoi Enti Shtetëror për Statistikë. Sipas të dhënave të publikuara çmimet me pakicë shënojnë rritje prej 0.2 për qind në krahasim me muajin maj të këtij viti ndërsa në raport me muajin qershor vitin e kaluar rritje prej 2.8 për qind. Të dhënat e publikuara tregojnë se tek shpenzimet e jetesës është vërejtur lëvizje në nëngrupet, gjegjësisht në krahasim me muajin e kaluar, është vërejtur rritje tek frutat e freskëta dhe të ftohura për 4.8 për qind, frutat e ngrira dhe frutat

e thata dhe produktet arrose për 0.4 për qind, jogurti, perimet e ngrira përveç patatja dhe frutat e tjera rrënjore për 0.3 për qind, djathi dhe gjiza, frutat e konservuara, sheqeri, mjalti dhe produktet konditore dhe produktet e tjera ushqimore për 0.2 për qind. Rritja e indekseve të shpenzimeve për jetesë është vërejtur edhe tek karburantet për amvisëritë për 4.8 për qind, shërbimet për akomodim për 3.7 për qind, shërbimet për kulturë për 3.5 për qind, paket aranzhmanet turistike për 2.8 për qind, gazi për amvisëritë, për 2.6 për qind shërbimet paramjekësore për 2.2 për qind shërbimet stomatologjike.

ANKOHEN AUTORITETET E KOMUNËS SË TETOVËS

BANESAT SOCIALE LARG TETOVËS!

“Deri më tani, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale janë ndërtuar 13 ndërtesa. Statistikisht 660 banesa edhe atë në Kriva Pallankë 44, Kavar 30, Berovë 51, Makedonska Kamenicë 29, Kërçovë 32, Koçan 29, Manastir 78. Fatkeqësisht, ka një diskriminim të madh në shpërndarjen gjeografike të këtyre banesave sociale”, tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës



e Gostivarit. Deri më tani, Tetova është anashkaluar nga harta gjeografike e shpërndarjes së banesave sociale.

Zëdhënës i Komunës së Tetovës, Armend Fazliu, shprehet se kanë bërë kërkesë deri tek Qeveria e kaluar për ndërtimin e banesave sociale, por nuk kanë marrë përgjigje. Sipas tij, pothuajse të gjitha qytetet me shumicë maqedonase kanë marrë banesa sociale, kurse Tetova ishte lënë anash. Ai theksoi se komuna vet nuk ka mundësi të ndërtojë banesa sociale për shkak të kostonë së lartë, por

këtë mund ta bëjë Qeveria, e cila deri tani, ka qenë e painteresuar.

“Deri më tani, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale janë ndërtuar 13 ndërtesa. Statistikisht 660 banesa edhe atë në Kriva Pallankë 44, Kavar 30, Berovë 51, Makedonska Kamenicë 29, Kërçovë 32, Koçan 29, Manastir 78. Fatkeqësisht, ka një diskriminim të madh në shpërndarjen gjeografike të këtyre banesave sociale”, tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës.

Nga Komuna e Tetovës thonë se janë në bisedime me Ministrinë

e Transportit për ndërtimin e banesave sociale dhe komuna është e gatshme të ofrojë tokë me të cilën menaxhon, kurse Qeveria të ndërtojë banesat. Sipas Fazliut, Tetova posedon me tokë që e menaxhon dhe e njëjta do ti jepet Ministrisë së Transportit për këtë destinim, por përgjigje sërish nuk ka.

“Nga ne është kërkuar që t’i sugjerojmë Qeverisë parcelë nga toka ndërtimore me të cilën menaxhojmë. Por diçka konkrete në këtë drejtim nuk ka edhe përkundër gatishmërisë sonë pozitive për të kontribuar me asi-

stencën tonë në përshejtimin e kësaj procedure. Në kuadër të këtij programi të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, në Tetovë është planifikuar ndërtimi i 55 banesave sociale, por deri më tani nuk është ndërtuar asnjë”, tha Fazliu.

Nga Qeveria e Maqedonisë njoftuan se është planifikuar të ndërtohet një ndërtesë për kategoritë sociale. “Shoqata aksionare për ndërtim dhe menaxhim me hapësira banesore në programën për ndërtimin e banesave sociale, e cila është në kuadër të projektit për strehimin e kategorive sociale, ka paraparë edhe një ndërtesë sociale në Tetovë. Sipas programës, ndërtesa do të fillojë të ndërtohet vitin e ardhshëm dhe do të përfundojë në vitin 2020. Ndërtesa në Tetovë do të ketë 46 banesa sociale”, deklaroi Muhamed Hoxha, zëdhënës i Qeverisë së Maqedonisë. Sipas informacioneve para-prake, në Gostivar nga ana e Qeverisë së kaluar ishin planifikuar të ndërtohen 77 banesa sociale. Qeveria e kaluar kishte planifikuar ndërtimin e banesave komerciale, por edhe ky projekt doli të jetë i dështuar.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 9 korrik - Ndonëse dhjetë vite më parë ishin ndarë 36 banesa sociale në Tetovë, në këto dhjetë vite e këndeje, Qeveria ka anashkaluar komunën më të madhe shqiptare. Së fundi, në ndarjen e banesave sociale ishte përfshirë Komuna

PËRKUJTOHET 9 KORRIKU I VITIT 1997

GOSTIVARI PËRKUJTON DËSHMORËT E FLAMURIT

Gostivar, 9 korrik - Komuna e Gostivarit ka përkujtuar Dëshmorët e Flamurit - Nazmi Saliu nga fshati Turçan i Vogël, dr. Shpend Iseini nga fshati Forinë dhe Milaim Dauti nga fshati Dobërdoll, të cilët më 9 korrik të vitit 1997, dhanë jetën e tyre për avancimin e të drejtave shqiptare dhe për flamurin kombëtar. Në mungesë për shkaqe objektive të kryetarit të Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, homazhe mbi varret dhe përmendoret e dëshmorëve, bëri një delegacion nga Komuna e Gostivarit në përbërje Besim Dogani - shef i kabinetit, Nazmi Jusufi - sekretar i komunës, Seadin Ejupi - shef i administratës komunale, Jasin Demiri - shefi i protokollit dhe PR-it, Aslian Snopçe - udhëheqëse e Sektorit për veprimtari publike, Muzafer Zubehari - drejtor i NP "Parkingje dhe gjelbërime", si dhe Afërdita Hamzai - anëtare e kabinetit të kryetarit Taravari.

Në homazhet të përmendorja e dëshmorit Milaim Dauti, delegacionit të Gostivarit iu bashkëngjiti edhe kryetari i Këshillit të Komunës së Vrapçishtit, Emir Durmishi dhe bashkëpunëtorët e kryetarit të komunës Isen Shabani. Rikujtojmë se 9 Korriku i vitit 1997 ishte një nga ndodhitë më domethënëse në mbrojtje të kauzës kombëtare që tronditi botën shqiptare dhe që u parapriu shumë kthesave dramatike në Maqedoni dhe më gjerë në hapësirën shqiptare. Konstelacioni i vitit 1997 ishte jashtëzakonisht i pafavorshëm për bartësit e fenomenit “flamuri kombëtar” në Gostivar, duke pasur parasysh kolapsin



politik dhe ekonomik në Shqipëri dhe Kosovë dhe vasalitetin e skajshëm të faktorit politik shqiptarë në Maqedoni. Me 9 korrik 1997 kur ndodhi intervenimi brutal, qeveria e Maqedonisë shpalli devalvimin e denarit për 17%, devalvim ky që u synua të mbulohej me intervenimin brutal policor mbi mijëra qytetarë dhe protestues paqësor të Gostivarit. Fakti që politikisht ngjarjet e vitit 1997 u mbyllën me raportin skandaloz të komisionit parlamentar se “policia përdori dhunën në pajtim me ligjin” përkundër pasojave të përgjakshme, argumenton faktin se tragjedia e flamurit e Gostivarit ishte bere nga koalicioni politik maqedono-shqiptar. Fakti që natën kur ndodhi intervenimi brutal policor, Kuvendi miratoi ligjin të cilin Komuna e Gostivarit e kërkonte në mënyrë demokratike nëpërmjet institucioneve komunale demaskon në tërësi komplotin politikë me sakrificat të mëdha

njerëzore. Gjykata Themelore e Gostivarit, e ndikuar nga politika ditore, u shqiptoi dënime drakonike krerëve komunalë të asaj kohe, kryetari Rufi Osmani u dënua me 13,8 vite burg dhe kryesuesi i këshillit Refik Dauti, me 7 vite burg. Përpjekjet institucionale për të realizuar një të drejtë të trashëguar kombëtare kishte një sakrificë të madhe që u ekuilibrua me jetën e tre dëshmoreve të flamurit Nazmi Saliut, Shpend Iseinit dhe Milaim Dautit. “Meritat për valëvitjen zyrtare të flamurit kombëtar shqiptarë para Komunës së Gostivarit sot si edhe në vitin 1997 u takojnë dëshmorëve të flamurit kombëtar. Le të jetë kujtesa historike dhe institucionale e përgjegjësia për nderimin e tyre dhe të flamurit kombëtar je të jetë detyrim i institucioneve komunale dhe qendrore”, thuhet në njoftimin e Komunës së Gostivarit. (U.H)

Shkup, 28 aksidente gjatë fundjavës

Shkup, 9 korrik - Dy këmbësorë, një bashkudhëtar dhe një shofer kanë marrë lëndime të rënda në katër prej gjithsej 28 aksidenteve të ndodhura gjatë fundjavës. Në 12 aksidente lëndime më të lehta kanë marrë 18 persona, ndërsa në 12 është shkaktuar dëm material. Nga MPB-ja informojnë se gjatë fundjavës policia ka zbuluar dhe ka sanksionuar numër të madh të veprave penale. Njëqind e tetëdhjetë e një shoferë kanë qarkulluar me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, katër shoferë kanë kaluar në dritë të kuqe në udhëkryq, dy shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve në vendkalimin e shënuar, një shofer është sanksionuar për parakalim të parregullt, ndërsa 22 shoferë për mospërdorimin e helmetës mbrojtëse. Janë sanksionuar edhe tetë këmbësorë të cilët kanë kaluar jashtë vendkalimit për këmbësorë dhe tre këmbësorë të cilët kanë kaluar në dritë të kuqe. Departamenti për parandalim pranë SPB Shkup sot në kuadër të projektit edukim trafik “Kulturë trafiku për fëmijët në institucionet parashkollore” do të realizojë punëtori për fëmijët nga grupi i mesëm dhe i madh në kopshtin e fëmijëve “Veseli Cvetovi” (Lule të hareshme), objekti “Mimoza” në komunën e Kisela Vodës.

Kur e humbëm Kosovën



Nga
Vuk DRASHKOVIÇ

E pyeti mësuesja Pericën e vogël: "Sa bëjnë dy plus dy?" "Trembëdhjetë", u përgjigj ai. "Pericë, i ke dy molla, pastaj mami t'i jep edhe dy. Sa molla do t'i kesh pastaj?" "Trembëdhjetë", përsërit Perica. "Mami t'i jep dy molla, ndërsa tezja edhe dy të tjera. Sa molla do t'i kesh gjithsej", këmbëngulë mësuesja. "Trembëdhjetë... q... shurdhacen", bërtet Perica. "Dialogu" i kësaj anekdote gjithnjë e më shumë të kujton "dialogun e brendshëm për Kosovën", i cili në Serbi po zhvillohet mes fakteve të pamohueshme dhe atyre, të cilët faktet dhe realitetin kosovar nuk e pranojnë. Lufta e shkurtër e Serbisë kundër aleancës së NATO-s përfundoi më 9 qershor 1999, me kapitullimin e pakusht të ushtrisë së Republikës Federale të Jugosllavisë së atëhershme (Serbia dhe Mali i Zi), të nënshkruar në Kumanovë. Të gjitha formacionet ushtarake, paraushtarake, policore, para policore dhe të gjitha formacionet e tjera të armatosura të shtetit të mundur, e braktisën përgjithnjë territorin e Kosovës, deri atëherë krahinë nën sovranitetin e Republikës së Serbisë. Me kapitullimin në Kumanovë, Kosova është shkëputur nga Serbia, thonë faktet. "As që na intereson kjo, Kosova është Serbi!"

Por, kapitullimin në Kumanovë të nesërmen e vulosi Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Rezoluta 1244 është miratuar, sipas Kapitullit të Shtatë të Kartës së OKB-së. Jemi përshkruar si shtet që ka fshehur krimet dhe katastrofën humanitare mbi shumicën shqiptare në Kosovë, që ka kërcënuar paqen rajonale dhe botërore, e në raste të tilla intervenimi i armatosur ndërkombëtar është i lejueshëm. Kështu me Rezolutën 1244 u legalizua bombardimi i NATO-s. Me atë Rezolutë tërë pushteti dhe administrata e Serbisë u dëbua nga Kosova dhe u përcaktua procedura, udhërrëfyesi, për t'i dhënë fund protektoratit të OKB-së në Kosovë dhe arritjes së pavarësisë së Kosovës. Rezoluta 1244, po ashtu ndaloi "kthimin në gjendjen e paraluftës, përkatësisht kthimin e Kosovës nën administrimin e Serbisë. Ndaloj edhe ndarjen e Kosovës dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Për të gjitha këto vendime

ka votuar edhe Rusia. Kanë votuar edhe të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Vetëm Kina ka abstenuar", -kështu thonë faktet. "Nuk na intereson, Kosova është Serbi!" Duke u thirrur në Rezolutën 1244, Kosova e ka shpallur pavarësinë, ndërsa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, ka gjykuar se ai vendim nuk është në kundërshtim as me të drejtën ndërkombëtare, as me Kartën e OKB-së, as me Rezolutën 1244", kështu thonë faktet kokëforta. "Ajo është gjykatë antiserbe, Kosova është Serbi!" -kjo është përgjigja që dëgjohej. "Shumica e shteteve anëtare të OKB-së dhe pothuaj të gjitha shtetet e BE-së dhe NATO-s, e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës", kështu flasin faktet. "S'janë gjë ato shtete.

Me neve janë Surinami dhe Burundi. Kosova është Serbi!" "Por, në Kosovë më shumë se 90 për qind janë shqiptarë dhe vetëm rreth 6 për qind serbë, dhe numri i tyre po bie me shpejtësi", -thonë faktet. "Edhe pa serbë, Kosova është Serbi", jehon përgjigja. Perica i vogël nga anekdota, me gjasë nuk e ka ditur sa bëjnë dy plus dy. Mohuesit e realitetit kosovar dinë gjithçka dhe

nuk pranojnë asgjë. Ata bëhen qëllimisht të shurdhër para fakteve dhe të verbër para realitetit. Ata janë peshkatarë të shpirttrave dhe ndjenjave të shumicës së serbëve, të cilët, me të vërtetë, nuk e dinë çka është nënshkruar në Kumanovë, as çfarë shkruan në Rezolutën 1244, as në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Nuk e dinë sepse, që nga kapitullimi në Kumanovë e deri më sot, të vërtetën për humbjen e Kosovës popullit ia fshehin të gjithë. Kisha, parlamenti, partitë, mediat. Gjithnjë e më hapur gazetave bulevardeske, me tirazh të madh dhe televizionet me frekuencë nacionale, çdo ditë, si mbrojtës të Kosovës i promovojnë njerëzit, të cilët para dy dekadave kanë nxitur represionin dhe krime ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe luftën e çmendur të Serbisë kundër aleancës së NATO-s. E verbojnë popullin me përralla duke thënë se, Millosheviçi e fitoi luftën dhe kërkojnë që për shkak të mbrojtjes së Kosovës t'i ngrihen përmendore. Përbetimi i Preambulës së Kushtetutës (së Serbisë), se Kosova edhe sot është krahinë nën sovranitetin e Serbisë, është kurora me të cilën mbulojnë mashtrimet e tyre dhe

kundërshtimin agresiv të Marrëveshjes së Brukselit dhe të çdo dialogu serbo-shqiptar mbi Kosovën. Populli i Serbisë nuk e di se teksti i Preambulës së Kushtetutës nuk e obligon askënd. "Rege impossibilium nulla obligatio", kjo mësohet që në vitin e parë të Fakultetit Juridik. Në serbisht: "norma e pamundshme nuk është e obligueshme". Për shembull, kur themi se njerëzit duhet të fluturojnë. Ose që kali është senator romak, siç e ka përcaktuar Kaligula. Serbia sot nuk ka sovranitet në asnjë metër katror të Kosovës. Forca dhe gjithë pushteti në atë territor janë në duart e shqiptarëve. Ky është realiteti. Mohimi i realitetit është "rege impossibilium".

Është e dhimbshme ta pranojë këtë, por duhet të pranohet. Alternativa është ndryshimi i realitetit, e ai mund të ndryshohet vetëm me luftë, madje me luftë me epilog fitues. E drejta kurrë nuk është në anën e të mundurve. Në luftërat e viteve '90 kemi humbur shtetin në të cilin jetonin të gjithë serbët. Në luftën kundër NATO-s e humbëm Kosovën. Në luftën e re, kjo është e qartë, do ta humbim edhe Serbinë. Vetëm duke pranuar realitetin kosovar

dhe në miqësi me popullin shqiptar, Serbia mund t'i ruajë dhe forcojë popullin serb të mbetur në Kosovë, kishat dhe manastiret serbe, pronat e tyre, tokën e tyre, territorin e tyre. Asgjë prej këtyre nuk është humbur as me kapitullimin në Kumanovë, as me Rezolutën 1244, as me dokumentin e Ahtisaarit, i cili është themeli i pavarësisë së Kosovës. Fitoret kurorëzohen me lavdinë e fitimtarit, ndërsa humbjet me dinjitetin e të mundurve. Në Luftën e Parë Botërore, para 100 vitesh, kur na priu Aleksandri i Madh (mendohet për Aleksandar Karagjorgjeviçin), kemi qenë fitues të mëdhenj. Hungarisë ia kemi shkëputur tërë Vojvodinën dhe ia kemi bashkuar Serbisë. Me rastin e nënshkrimit të kapitullimit, në Pallatin e Trianonit, delegatët hungarezë erdhën të veshur me kostume të zeza. Nënshkruan, vajtuan dhe kënduan himnin kombëtar!

(Vuk Drashković është shkrimtar dhe politikan serb. Ai është kryetari i Lëvizjes Rilindase Serbe, ka qenë deputet, kryeministër i Republikës Federale Jugosllave dhe Ministër i Jashtëm i Serbisë dhe Malit të Zi, në vitet 2004-2007)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 9 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Spektakli i Trumpit vjen në Europë. Titujt kryesorë i ka siguruar që tani presidenti për javën e ardhshme. Ai mund t'i trembë Kanadanë dhe partnerët europianë në Bruksel. Ai mund të shkelë rregullat në çajin me mbretëreshën. Ai mund të lidhë miqësi burrash në Finlandë pas një loje golfi me presidentin Putin. Ka pasiguri në Bruksel për turneun europian të presidentit „America First” që gjendet në fushatë zgjedhore. Trump nuk do të ketë drojë të hapë gojën për faturat absurde për mbrojtjen. Vërtet që europianët shpenzojnë më shumë për ushtrinë, por kjo nuk i mjafton Trumpit. Për të kuptuar si mendon Donald Trump mjafton të dëgjosh fjalimin e tij të fushatës zgjedhore në Indiana javën e fundit: Ai përmendi direkt kancelaren Merkel, duke pyetur, se çfarë parash po merr nga gjermanët? Gjermanët bëjnë pazare energjitike me rusët, dhe ne amerikanët jemi budallenjtë që paguajmë çdo gjë. Këtë do ta ndryshojë Trump sigurisht dhe kërcënon me tërheqje të mundshme trupash nga Gjermania.

MBROJTJE KUNDREJT PARAVE?

Në fantazitë më të këqija të diplomatëve në Bruksel shihet edhe një lloj vendosjeje tarifash për trupat amerikane në Europë. Mbrojtje kundrejt parave. Para për të mbrojtur? Nuk u mendua në kategori të tilla për aleancën që bazohet në vlera politike. Donald Trump mendon kështu. Ai kërkon avantazhin e

Samiti më i vështirë i NATO-s



tij, e për këtë ai negocion fort pa marrë parasysh partnerët. Këtë ai e ushtroi njëherë në samitin e G7-s në Kanada. Do të ishte një çudi, nëse ai nuk e përdor këtë metodë të suksesshme edhe tek NATO. Europianët duhet të përgatiten. Trump i përzien konfliktet tregtare dhe politikën e sigurisë. „Doni mbrojtje atomare nga rusët, atëherë lejoni produktet amerikane pa dogana në Europë.” Ky është ekuacioni i thjeshtë i Donald Trump.

Burri i shtetit në Shtëpinë e Bardhë shkon më mirë me dikta-

torët dhe autokratët se me aleatët, që ai i mban për parazitë. NATO do të përpiqet të bindë Trump, se gjithnjë e më shumë shtete po lëvizin drejt objektivit të 2% shpenzime për mbrojtjen. Gjermania është shumë e ngadalshme në këtë drejtim, gjendja e Bundeswehrit është dëshpëruese. Edhe aftësia vepruese e trupave europiane lë për të dëshiruar. Me këto probleme do të duhet të dalë para Trumpit Angela Merkel në Bruksel. Dhe presidenti amerikan do ta shfrytëzojë momentin. Ai ndodhet në fushatë zgjedhore për

NATO shpreson që anëtar i saj më i rëndësishëm, SHBA të mos shkaktojë dëme të mëdha në samitin e Brukselit të mërkurën. Po, në këtë pikë kanë arritur marrëdhëniet transatlantike



zgjedhjet e kongresit amerikan në nëntor.

Të ardhmen e marrëdhënieve brenda NATO-s e ka skicuar Ministria e Mbrojtjes e Polonisë. Polakët kanë ofruar dy miliardë në vit për stacionimin e trupave amerikane. Ky model mund t'i pëlqejë Trumpit. Shtetet e NATO-s vetëm mund të shpresojnë, që presidenti i fuqisë më të rëndësishme ushtarake të njohë detyrimin për ndihmë brenda aleancës. Në rastin më ekstrem ai mund të kërcënojë me shfuqizimin e kësaj për të realizuar kërkesat e tij. Kjo nuk

përjashtohet, para dy vjetësh ai e quajti NATO-n të vjetruar. Ndërkohë që ngritja e një bashkëpunimi ushtarak të fuqishëm brenda BE do të kërkojë vite.

DO TA NDIKOJË TRUMPI PUTININ?

Zemërdridhur europianët presin samitin e kreut të Kremlinit, Vladimir Putin. Shumë vende europiane e shohin Rusinë si rrezikun kryesor. Në këtë takim do të flitet për një listë të gjatë problemesh: nga konflikti në Ukrainë deri tek lufta kibernetike. Samiti i NATO-s do të përpilojë rekomandimet. Nëse Donald Trumpit do t'i kujtohen këto rekomandime, kjo mbetet të shihet. Ai është i përgatitur për gjithçka në takimin me Putinin, tha Trump. Nëse gjërat shkojnë mirë, sipas këndvështrimit të NATO-s, Trumpi do të duhet ta ndikojë Putinin. Nëse gjërat shkojnë keq, frontet do të ashpërsohen.

Esigurt është: spektakli i Trumpit është i suksesshëm, gjithmonë sipas mënyrës së tij. Vetëlëvdatat e tij të tingëllojnë që tani në vesh: NATO, Mbretëresha, Putin? Do të jetë fantastike. It's gonna be great!

(DW)

Nga
Bernd RIEGERT



Dilema ka të bëjë me atë se edhe sa duhet të vazhdoi një apati e këtyllë pa vërejtur prej askujt, në mënyrë që të ndodhë një pikë kthese e njerëzimit ta ndryshojnë qasjen, të vërtetën ta shohin në sy dhe të ndryshojnë qëndrimet, në rend të parë ta ndryshojnë vetveten ndaj qëndrimeve të deritashme që kanë. Jo se pastaj do të jetë lehtë, por së paku do të bëhet një nismë përpjekje e ndryshimi



Koha e ndryshimeve të mëdha rezultoi me krijimin e një strukture mentale, mënyrë të të menduarit, që për këto troje e për këto vite nuk ishte parë - zotimit për realizimin e interesit punë, jashtë aftësive e përgatitjes profesionale, duke keqpërdorë pozitë pushteti e duke komprometuar proceset

Diletantizmi kundrejt dinjitetit njerëzor

përmirësuese të tij. Ndërkaq, shekulli i njëzet do të shënohet si shekulli i sprovimit më të madh arsimorë-shkencor, kulturës përgjithësisht, por edhe i tejkallimit të sprovave të tjera, të vendeve me përballje ndryshimesh. Lëvizjet migruese të këtyre trojeve, kanë qenë karakteristike e përherëshme, që gjithsesi ka imponuar këmbimin e gërshetimit e vlerave e përvojave të ndryshme jetësore të vendeve të ndryshme, për të përmirësuar standardin e të jetuarit. Një arritje e këtyllë nënkuptonte, ndërmyjet tjerash, zotësinë për përbrendësimin dhe vënien në praktik të këtyre të dhënave në njëherë anë, e në tjetrën respektimin e kriterëve dhe hierarkisë profesionale për vlerësimin e gjithë kësaj, e individët e përzgjedhur duhej kaluar përmes përzgjedhjes e hierarkisë profesionale për të marrë një thirrje a një titull profesionali të përkushtuar për këtë: thje-

sht, duhej poseduar kuantumi minimal dije për të marrë një dëshmi prej profesionisti, për të qenë pjesë e proceseve dhe sendërtimit të tyre. Pika më e lart u arit në pragun e ndryshimeve të mëdha, ndër këto hapësira shtetesh të shpërndara.

Në ndërkohë, duket qartë se në disa vende në ndryshim e sipër; të ndryshimeve e zhvendosjeve të mëdha gjeopolitike, del në duke në mënyrë të dukshme diletantizmi, si zëvendësim i profesionalizmit e dinjitetit njerëzor, si tërësi e vlerave morale e vetëdije e njeriut për to e për të drejta të tij. Ndërsa sot, sheh gjithnjë e më shumë njerëz që merren me veprimtari shkencore, të artit, arsimit, e politike, pa pasur përgatitjen e veçantë që i nevojitet dhe, pa pasur njohuri të plota e të thella, nga fusha në të cilën e ushtron veprimtarin. Mjafton të përkasësh një parti politike, të jesh një ushtar pa tru dhe

pa gojë deri në atë masë sa nuk e rrezikon lidhshpin, përkatësisht, deri në atë masë sa të kërcënohet e rrezikohet jetën e dikujt, dhe do të jesh pjesë e strukturës dhe hierarkisë vendimmarrëse të strukturave në fjalë.

Shoqëritë me shkallë të ulët të organizimit por me anëtar me shkallë të lartë fanatizmi, në të cilat dominon vetëdija e ulët, ndërmyjet tjerash edhe social politike, krijojnë hapësirë të mjaftueshme për të ardhur në shprehje diletantizmi e degradimi i vlerave, që u krijuan për një kohë të gjatë: si në nivelin e arritjeve të përgjithshme kulturë ashtu edhe të traditës. Gjithnjë, përkundër rritjes së nivelit të korrupsionit që i kalon të gjitha përmasat kohore, nëse mund të quhet të një kohë e nevojshme normale-stabile për zhvillimin e një shoqërie; të rënies së dinjitetit njerëzor: tanimë sheh rrallë njerëz dinjitoz e të përkush-

tuar ndaj punës e profesionit. Krijohet përshtypja e gabuar se të jesh i suksesshëm në jetë duhet të jesh pak i çmendur e pamëshirshëm në çmendurin. Shkathtësia matet me atë sa mund të jesh depërtues në çështje krimi, sa mund të jesh depërtues në çështjen e strukturave vendimmarrëse partiake, e sa mund ti korrupsionit e ndjeshme të shoqërisë e shtetit duke zbatuar presion korrupsioni. Dilema ka të bëjë me atë se edhe sa duhet të vazhdoi një apati e këtyllë pa vërejtur prej askujt, në mënyrë që të ndodhë një pikë kthese e njerëzimit ta ndryshojnë qasjen, të vërtetën ta shohin në sy dhe të ndryshojnë qëndrimet, në rend të parë ta ndryshojnë vetveten ndaj qëndrimeve të deritashme që kanë. Jo se pastaj do të jetë lehtë, por së paku do të bëhet një nismë përpjekje e ndryshimi.

Nga
Bajram SELMANI



“MUZAT E ALPEVE 2018” PËRKUJTOJNË BASRI ÇAPRIQIN



Karvani i shkrimtarëve nga rajoni në ditën e dytë të manifestimit “Muzat e Alpeve 2018” me një orë letrare ka përkujtuar poetin dhe studiuesin Basri Çapriqi dhe krijimtarinë që la ai pas vetes.

Manifestimi letrar ndërkufitar “Muzat e Alpeve 2018” i Shoqatës Rajonale e Shkrimtarëve “Teuta” realizuar në bashkëpunim me Teatrin Shqiptar në Amerikë si dhe me Shoqatën e Artistëve dhe Shkrimtarëve “Art Club” të Ulqinit, sivjet filloi në Gjakovë, vazhdoi në Ulqin dhe do të përmbyllet në Krujë me ndarjen e Çmimit për Vepër Jetësore “Teuta”

Ndërsa, sipas kryetarit të komunës së Ulqinit Loro Nrekiq, “Muzat e Alpeve” kanë kapërcyer kufijtë rajonal duke dëshmuar fjalët e shkrimtarit të mirënjohur malazet Jevrem Berkoviq, i cili me rastin e pranimit të Çmimit për Vepër Jetësore “TEUTA” pat thënë se miqësia e popujve fillon nga shkrimtarët dhe se manifestimet si “Muzat e Alpeve” udhëheqin drejt jetës së përbashkët. Kryetari Nrekiq me këtë rast shtoi të jetë tejte i lumtur ky aktivitet letrar zhvillohet edhe në qytetin e Ulqinit, kultura e të cilit daton qe 2500 vjet dhe vazhdon të nxjerr artistë e shkrimtarë, të cilët me krijimtarinë e tyre zënë vend të rëndësishëm në letërsinë mbarëshqiptare. “Nder ta padyshim është edhe poeti dhe kritiku i mirënjohur dr. Basri Çapriqi i cili u nda nga jeta por la pas vetes veprimtarinë me të cilën i ka siguruar vetvetes vend nderi në panteonin e kulturës shqiptare. Ndaj, siguroj artdashësit e veçanërisht “Teutën”, i siguroj se gjithmonë në mbështetjen e komunës së Ulqinit”.

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Mal të Zi, Skender Durmishi tha se takime dhe komunikime të artit, të kulturës dhe të shkencës na duhen më shumë se çdo gjë tjetër sepse, është mungesa e komunikimit mes njerëzve ajo që prodhon negativitet, mosnjohje, mospranim dhe gjëra të tilla të cilat i mbajnë distancat gjithmonë aktive.

Sikur dje në Gjakovë zv/ministria e kulturës, rinisë dhe sportit të Repu-

blikës së Kosovës, Burbuqe Bakija Deva edhe të shtunën në Uqlin, Albert Kurtulaj, zyrtar i lartë për koordinim të politikave në Ministrinë e Kulturës, Rinsë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, tha: Meqëse aktivitete të këtij niveli ndihmojnë afirmimin e vlerave dhe integritet kulturor, “Muzat e Alpeve” ka gëzuar mbështetjen e përhershme të ministrisë sonë. Ndërsa, Ismet Kallaba, kryetar i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve “Art Club” në Ulqin-bashkorganizator i manifestimit, ndër të tjera tha se: “Letërsia dhe kultura në përgjithësi i bashkon popujt, nxisin dhe i paraprinë bashkëpunimit në fusha të ndryshme, me qëllim të njohjes dhe të komunikimit të ndërsjellë. Ndërsa, në këtë kohë nisma të bashkëpunimeve rajonale në nivele shtetërore si manifestimi letrar ndërkufitar “Muzat e Alpeve” i ka paraprirë dhe i shërben më së miri këtij qëllimi”.

Ndërsa, shkrimtarja dhe gazetarja Ajete Bëqiraj, kryetare e Shoqatës Rajonale të Shkrimtarëve “TEUTA”, shprehu mirënjohjen e veçantë ndaj kryetarit aktual të komunës së Ulqinit Loro Nrekiq, për mundësinë e ndalimit me aktivitete edhe në Ulqin në të cilin siç tha, nuk iu ishte ofruar mundësi ta bënin përgjatë viteve paraprake në një nivel të tillë dhe se Ulqini ishte prehri i romanit të saj të parë rinor “Ylli i Fatit i pushonte në dorë”.

“S ke me dal nga parajsa”, ishte poezia me të cilën prof.dr. Sali Bashota filloi kumtesën kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit dhe studiuesit të mirënjohur ulqinak Basri Çapriqi, i cili iu përkiste gjithë hapësirave mbarëshqiptare dhe la pas vetes një bagazh të pavdekshëm në thesarin e letërsisë mbarëshqiptare, ballkanike e me gjërë ndonëse pa i mbush te 58-tat iku nga kjo botë tokësore për t’u ngritur përgjithmonë në botën e pavdekshme

të vlerave letrare të letërsisë shqipe.

Ndërsa, shkrimtari i mirënjohur malazet Mirash Martinoviq, laureat i 4 i Çmimit “TEUTA” në hapje të orës letrare kushtuar jetës dhe veprës së Basri Çapriqi solli përshëndetjet e akademikut Jevrem Brkoviq. “Berkoviq që nga lindja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i kësaj ideje ka qëndruar me ne dhe ka qenë gur themeltar i këtyre takimeve e roli i tij dihet kur ishte në pyetje populli shqiptar në ato kohë të errëta. Ndërsa në promovimin e librit Ardhësit-Këngët e Ali Binakut”, të Radovan Zogoviqit, ai tha diçka të mrekullueshme: “Në histori ekzistojnë momente të caktuara në të cilat shkrimtarët e mëdhenj i ndërgjegjësojnë popujt e tyre. Me këtë rast unë mendoj në Zogoviqin, Berkoviqin, Ali Podrimen, në gjithë plejadën e laureatëve të Çmimit për Vepër Jetësore, “TEUTA”, përfshirë edhe Basri Çapriqin i cili do duhej të ishte këtu me ne, për të pasuruar manifestimin tonë me madhështinë e tij dhe me veprën moderne dhe evropiane. Letërsia shqipe do të jetë krenare me veprën e tij e cila do të mbetet gjithmonë objekt vëmendjeje”. Xhevdet Capriqi falënderoi organizatorët për përkushtimin ndaj të vëllait, Basri Capriqi, programi për të cilin vazhdoi me lexim poezishë dhe evokime kujtimesh.

Dita e dytë e manifestimit Letrar Ndërkufitar “Muzat e Alpeve 2018” u përmbyl me mirënjohje për “Art Club”-in dhe për kryetarin e komunës së Ulqinit Loro Nrekiq, si dhe me një darkë të përbashkët shtruar nga komuna e Ulqinit. Përderisa, dita e tretë e manifestimit vazhdon në qytetin e Krujës, ku edhe do të ndahet Çmimi për Vepër Jetësore “Teuta”, shkrimtarit të mirënjohur nga Kosova, Nazmi Rrahmanit./KOHA.net



VANESSA REDGRAVE VJEN SËRISH NË PRISHTINË

Mysafirja speciale e festivalit PriFest, ylli i filmit Vanessa Redgrave, do ta prezantojë filmin e saj “Sea Sorrow” dhe do ta pranojë çmimin “Hyjnesha e Artë”, çmim falënderues për mbështetjen e saj të vazhdueshme ndaj festivalit, kinematografisë kosovare dhe gjithë komunitetit artistik.

Gjatë javës së festivalit, mes datave 17 dhe 22 korrik, gjithsej 58 filma do të shfaqen në programe të ndryshme garuese dhe jogaruese, të përfshira do të jenë gjashtë premiera botërore, dy ndërkombëtare, tri evropiane dhe 14 rajonale.

Shumë mysafirë pritet të jenë pjesë e festivalit, për t’i prezentuar filmat e tyre apo për të qenë pjesë e PriFORUM-it, platformës industriale të zhvillimit të filmit në rajon.

Një nga mysafirët e rëndësishëm të festivalit do të jetë Vanessa Redgrave, aktore britanike, fituese e çmimit “Oscar”.

Festivali do të vazhdojë të organizojë aktivitete të ndryshme edhe këtë vit, si programi i projekteve filmike rajonale i quajtur “Best Pitch”, i organizuar nga PriFORUM-i, dhe Prishtina Rendezvous – një aktivitet i dedikuar që distributorët dhe agjentët e shitjes nga e gjithë Evropa të mësojnë më shumë për projektet filmike ballkanike dhe të takojnë filmbrsit nga kjo pjesë e botës. Në PriFORUM do të ketë edhe shumë aktivitete të tjera.

Në industrinë e filmit në PriFORUM paneli kryesor do të jetë “Kosovo ready to roll” që do të promovojë lokacionet e xhirimit, kapacitetet njerëzore dhe aktorët e Kosovës të gatshëm për projekte filmike ndërkombëtare.

“Ne jemi shumë të lumtur dhe të nderuar që Vanessa Redgrave do të rikthehet në Prishtinë për ta vizituar festivalin tonë. Është një gjë e mrekullueshme! Ajo ishte këtu në edicionin e parë, kur ne kishim nevojë më së shumti për të dhe tash ajo rikthehet këtu për ta festuar me ne një përvjetor të veçantë – një dekadë të PriFest. Për më tepër, ajo në PriFest do ta sjellë filmin e saj të parë të punuar si regjisore, filmin “Sea Sorrow” që vitin e kaluar kishte premierën botërore në Cannes, një film shumë personal e dinamik që trajton temën e krizës globale të refugjatëve. Në shenjë respekti dhe vlerësimi për gjithë përkrahjen e saj ndër vite për komunitetin artistik në Kosovë dhe festivalin, PriFest-i do ta shpërblejë atë me çmimin “Hyjnesha e Artë”.

Ajo ishte me ne kur ne ishim refugjatë në Maqedoni, na vizitoi në kampe dhe na inkurajoi që të qëndronim të fortë. Më pas, ajo u rikthye në Prishtinë në shtator të vitit 1999 për ta organizuar një festival të mrekullueshëm të muzikës dhe teatrit. Ky festival quhej “Kthimi” dhe kishte për qëllim festimin e rikthimit të refugjatëve në shtëpitë e tyre në Kosovë. 10 vite më vonë, ajo u rikthye në ceremoninë hapëse të PriFest-it, për ta hapur festivalin dhe për ta pranuar rolin ‘Presidente e Bordit të Nderit të festivalit’. Tash ajo po rikthehet përsëri dhe ne jemi shumë të lumtur për këtë vizitë.” – u shpreh Vjosa Berisha, drejtoresha e PriFest-it, me shumë entuziazëm.

PriFest risjellë në Kosovë mysafiren speciale Vanessa Redgrave



MARIN BARLETI, URA E PARË LIDHËSE MES SHQIPËRISË DHE EVROPËS



Në gjithë aradhën e humanistëve me prejardhje nga tokat shqipfolëse, dallohet si kryesues e si xhevahir ndriçues i madhi dhe i pakrahasueshmi, historiani, kronikani e shkrimtari, prifti i urdhrat të fretërve minorë Marin Barleti. Figura e tij është aq e shquar, sa studimet për të vazhdojnë akoma edhe sot, shekuj pas vdekjes së tij. Të dhënat biografike, sado që shtrëmbërohen me ose pa dashje nga studiues të huaj e shqiptarë, na vijnë nga dy veprat e tij kryesore "Rrethimi i Shkodrës" dhe "Historia e Skënderbeut". Ndër këto dy vepra, Barleti përmend Shkodrën time

çka do të thotë se ai ishte shkodran. Vendlindja e tij ndikoi aq shumë në jetën dhe formimin e tij, por edhe ai ndikoi shumë në ruajtjen e historisë së Shkodrës së shquar. Studiues, kryesisht rumun, kapen pas mbiemrit të tij duke e lidhur me krahina në Itali apo të tjerë vende të Evropës, por profesori Eqrem Çabej është i prerë kur thotë se mbiemri Barleti lidhet me mbiemrin Barleci si patronim në Veriun e Shqipërisë. Disa nga studimet e Jahja Drancollit na e japin Marinin jo me mbiemrin Barleti, por Barleci, prandaj shpjegimi etimologjik i bërë nga Çabej, me sa duket është i drejtë

dhe me baza gjuhësore e historike.


Një tjetër fakt interesant që vjen tërthorazi nga jeta e Barletit është fakti se ai, shkollimin e hershëm e ka marrë në Shkodër, çka rrjedhimisht do të thotë se në Shkodër ka pasur shkolla qysh në shekullin XV. Disa kohë më parë kam bërë disa përpjekje për të zbuluar të parat shkolla shqiptare të cilat datojnë diku rreth shekullit XIII, sipas revistës "Hylli i Dritës".

Vepra e Barletit, e botuar në latinisht, ka qenë dhe vijon të jetë baza e studimit të historisë së Skënderbeut dhe asaj të qytetit të Shkodrës. Sipas profesoreshës Ermira Alija, përkrah shtatores së Skënderbeut duhet të jetë edhe një bust i Barletit, pasi po të mos kishim këtë kolos të humanizmit, me shumë mundësi historia e heroit tonë Kastriotas do të ishte larguar, ose të paktën venitur, bashkë me historinë.

Gjithashtu, vepra e Barletit "merret seriozisht" pasi ndryshe nga pjesa dërrmuese e veprave të kohës që trajtojnë tema për kohën aktuale por tani historike, ajo ndërtohet mbi disa burime, ku përfshihet Marin Beçikemi dhe Gjergj Merula.

Figura e Barletit nuk duhet lënë asjëherë mënjanë dhe duhet të vijohet të studiohet, me do e mos, edhe sot e mot./ *Konica.al*

"Shqiptarët në shtypin britanik 1774-1856" si tablo për tetë dekada



Në historiografinë bashkëkohore gjithnjë e më tepër po vërehet trendi i studimit të informacioneve të ofruara nga mediat e shtypit për ta ri-konstruktuar të kaluarën apo për t'iu qasur një problemi të caktuar historik.

Studimi dhe analizimi i informacioneve të tilla çojnë në ndërtimin e një tabloje më të gjerë të një çështjeje historike, sepse mediat pasqyrojnë perceptimin e qëndrimeve të njerëzve të kohës, mentalitetit dhe botëkuptimit të tyre, përfshirë shtresa të ndryshme, qoftë gazetarë, politikanë, ushtarakë, tregtarë apo njerëz të rëndomtë; pastaj ofrojnë qasje shumëdimensionale ndaj një problemi, shpeshherë të përcjella me krahasime të zhvillimeve ndërkombëtare; përveç tjerash ofrojnë edhe perceptimin sociologjik e psikologjik përmes shkrimeve mbi mënyrën e jetës dhe të ushqimit, sjelljeve, kushteve të banimit, traditave, religjionit, etj., që për një historian modern ofrojnë lehtësi të dukshme në lidhjen logjike të ngjarjeve, shkruan Armend Mehmeti, në numrin e sotëm të gazetës Koha Ditore.


Prandaj, duke ndjekur një trend të tillë, studiuesi i historisë, prof. i asoc. dr. Memli Krasniqi na sjell studimin e titulluar "Shqiptarët në shtypin britanik (1774-1856)". Në këtë studim, të shkruar në 407 faqe, autori bazohet plotësisht në të dhënat e gazetave britanike, pra angleze, skoceze, irlandeze dhe uellsiane, të vjela nga arkivat e Bibliotekës britanike, kur dihet se Britania njihet si njëra ndër vendet e para në botë ku lindi gazetaria moderne, sidomos kur kihet parasysh se ajo respektonte lirinë e shtypit dhe ishte jashtë ndërhyrjeve të politikës ditore, së paku në aspektin e shkrimeve me karakter ndërkombëtar. Për t'i dhënë studimit një karakter sa më shkencor dhe për të ofruar argumente sa më të pasura historike autori përdor edhe burime primare nga Arkivi Kombëtar Britanik, Arkivi Osman, Arkivi Kombëtar i ShBA-së, Koleksione nga Biblioteka Kombëtare Amerikane, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, etj. Po ashtu autori përdori një varg burimesh dokumentare të botuara, me theks të veçantë dokumente nga provenienca bullgare, serbe, maqedonase, turke, etj. Sigurisht që nuk mungoi analizimi i një literature të gjerë të gërshtuar me studimin e të dhënave nga interneti.

NIKOLLË TOMEIO, SHQIPTARI QË PËRKTHEU I PARI ARISTOTELIN

Ndonëse veprimtaria e Tomeot i jep këtë titull të fundit një karakter poliedrik, diçka e natyrshme për kohën kur jetoi dhe veprimi, pasi figura si ai që zotëronin atë dije dhe atë kulturë nuk mund të ishin ndryshe, në historinë e përkthimit ai do të mbesë si i pari përkthyes i veprave të Aristotelit në lëvizjen humaniste të Rilindjes Evropiane. Për këtë arsye, kësaj figure të jashtëzakonshme e cila del jashtë kufijve të një humanisti të thjeshtë, sot duhet t'i njihet merita, pasi falë tij dhe disa murgjive kemi Aristotelin. Po të mos ishte për Tomeon, vepra e Aristotelit do të ishte përkthyer më vonë dhe, sikurse dihet, me kalimin e kohës ajo do të ishte

tkurrur, ndoshta ndjeshëm. Pas përkthimit të bërë nga Tomeo, murgjit e asaj periudhe morën dorëshkrimin dhe e rishkruan spas një formati të tillë. Një murgj rrinte në krye, në një lloj podi pak të ngritur dhe me zë të ngadaltë lexonte dorëshkrimin e përkthyer nga Tomeo. Murgjit e tjerë, ulur para skrikanive shkruanin çfarë dëgjonin, duke përdorur një kaligrafi magjike. Kështu, nga një dorëshkrim i vetëm i Tomeot dilnin më shumë se pesëdhjetë brenda një kohe, relativisht jo shumë të gjatë. "Arti Poetik" i Aristotelit, përkthyer nga Tomeo, do të kthehej në bazën e poezisë

dhe librave studimorë të kohës, përfshirë edhe "Arti Poetik" të Nikola Bualo, përkthyer vitin e shkruar nga Vinçens Marku. Falë këtyre përkthimeve dhe studimeve të kryera mbi këto vepra, ai njihet si Aristotelisti më i mirë i kohës së humanizmit. Por kontributi i tij në fushën e përkthimit nuk ishte kaq i ngushtë. Përpos Aristotelit, ai përktheu dhe punoi shumë edhe me të tjerë autorë të hershëm. Disa përkthime panë dritën e rishkrimit sipas modelit të lartcituat e më pas, shekuj më vonë të ribotimit, ndërsa disa të tjerë mbetën ndër dorëshkrime deri sa u grisën nga dora e pamëshirshme e shekujve.



Një zë i përherëshëm në poezinë europiane

Mateja Matevski ditë më parë u nda nga jeta dhe la pas një trashëgimi të pasur krijuese. MATEJA MATEVSKI është njëri nga emrat kulmorë të poezisë bashkëkohore në Maqedoni. Në të njëjtën kohë, ai është emër i respektuar edhe i kritikës letrare e teatrore si dhe përkthimit dhe esesë, antologjistit e profesorit universitar. Lindi në Stamboll të Turqisë më 13 mars 1929. Është diplomuar në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Shkupit. Fillimisht ka punuar si gazetar në programet kulturore e letrare të Radio dhe Televizionit të Shkupit (drejtor), pastaj redaktor i revistave letrare dhe në Shtëpinë botuese Koço Racin. Më 1962/63 shkon për studime në Paris, ku studion teatrin bashkëkohor francez. Më vonë bëhet profesor i rregullt në Fakultetin e Artit Dramatik, ku ligjëron lëndën Historisë së dramës dhe të teatrit botëror. Është anëtar i rregullt i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Maqedonisë (kryetar i saj më 2001-2004) dhe anëtar me korrespondencë i Akademisë së Amerikës Veriore të gjuhës spanjolle në Nju Jork, i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i Akademisë së Arteve dhe të Shkencës të Sllovenisë, i Akademisë Norvegjeze të Letërsisë dhe Lirisë të Fjalës i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve në Salzburg dhe i Institutit shkencor "Sesar Valego" në Truhilo të Perusë.

Matevski është njëri nga themeluesit e festivalit të njohur Mbrëmjet Strugane të Poezisë (dhe kryetar i Këshillit Drejtues), i festivalit Takimet e Racinit në Veles dhe i Verës së Ohrit. Ka qenë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë, i PEN Qendrës të Maqedonisë (tani kryetar nderi) dhe i Fondacionit të Letërsisë të Maqedonisë.

M. Matevski është autor i 19 librave me poezi (e para Shira -1956 dhe e fundit "Zgjyrë", "Ecje nëpër ujë", "Hoje" – 2012). Shirat, Ekuinoks, Luleshpate, Bliri, Rreth, Bliri, Lindja e tragjedisë, Largimi, Kulla e zezë, Fërfëllizë, Amulli, Anë e brendshme, Përtej harresës, Përgjërimi për të plotën, etj. Poezia e tij është përkthyer në të gjitha kontinentet.

Përveç çmimeve më të rëndësishme të Republikës, Matevski është fitues edhe i 15 çmimeve për opusin e tij krijues: The Cendrars International Aëard at the Intrnacional Biennale for Poetry in Yverdon, Sëitserland (Recontres poetiques en Suisse romande), the Premio Mediterraneo, aspecial aëard for literature, in Palermo, Italy, the Premio Mundial Fernando Rielo de Poesia Mistica in Madrid. Spain, the Zupancic Aëard of the Slovenian Eriters' Union and of the Slovenian PEN Centre, the Goran Eëath Aëard at the Goran Spring Festival of Poetri in Zagreb – Lukovdol (Kroaci), Çelësi i artë i Smederevës (Serbi), the Ballkan Aëard Erguvan in Chatalca Turqi), the Aëard Atlantida in Las Palmas (Spanjë), Majkëll Mahdusudan (Kalkutë), Preio Internazionale Trieste Poesia, Italy; International Smederevo Golden Key Aëard, on the "Smederevo Poetry Autumn", Serbia and Montenegro, the Romenien Publishers' Association Aëard, Romania, the Michael Madhusudan Academy Aëard for Poetry in Calcutta, India, and the Premio Mediterraneo of the Acadaemia Mediterranea, Napoli, Italy, in 2005, Jan Smrek në Bratislavë, 2010, Jan Smrek, të Festivalit të Bratislavës (Sllovaki), Poet i entuziazmit, Indi.

Çmimi Kurora e artë e Mbrëmjeve Strugane të Poezisë në 2011 është çmimi i 15-të i tij. Matevski është bartës edhe i çmimit prestigjioz Merita për Maqedoninë dhe atij të Francës Legjioni i Nderit.

Vdiq në moshën 89 vjeçare, në Shkup, më 6 qershor, 2018.



MATEJA MATEVSKI

KULLA E ZEZË

*E rëndësishme tani është të kuptohet
të zbulohet e të kapet
se çfarë ndodhi në kullën e zezë
errësirën e mallkuar
nga vinin të gjitha gjëmat
përmes frikrave
ëndrrave të thyera
plagëve
nga gromësinjë zjarret në qiellin e shushatur
si nga sy përbindëshi
nga gryka e kuçedrës
Ndërsa qyteti nën atë kullë i fshehur në pagjumësi
në ethe ankthi
me shekuj dridhet
nga sëmundjet uria masakrat e tmerrta
duke dëgjuar lart mbi vete shkrepjen e shpatave
gjëmimin e zjarreve
klithmat e ndoshta
të luftrave e ushrive
Dyert e errëta të kullës i villnin
në terr
në natën e njeriut
të përgjunjur
në pluhur
me qytetin e vet
me gardhet
me kopshtet
gjersa shkruarbohen drejt Gjithësisë shkretëtirë
drithërat e pakorrura
të shpresës
Lartohet ajo në errësirën e natës nga vet errësira
mitër e errët e territ
fortesë e padukshme
kullë vërtet misterioze dhe e largët
krahë shpendi të zi shpend habertar
i kobit
që qiellin mbulon
Lartohet ajo duke përzierë ditën e terrin
në errësirën më të zezë
derën e zezë të pagjumësisë me grykat e honeve përpirë
ku gremisen shekujsh
nga guvat shkëmbore te shenjat e gurta
mbi ballin
ku zërin na e gëlltit mosqenia*

*në pusin e shqetësimit
Ngrihet kulla e zezë që t'ua kalojë
dhe qiellit dhe ditës dhe frikës dhe gjumit
të mbushë gjithë hapësirën gjithë kohën
me hijen e saj të errët
me vetveten
gjithçka që mund të ketë nën mbulesën e yjeve të shuar
Lartohet ajo kërcënuese e heshtur
kulla e zezë enigmatike
kulla e mallkimit të përherëshëm
e paprekshme kulla e parrënueshme
as dorë e shklatërron
as mendim e largon
në paqëndrueshmërinë e ditës
që ditët e groposin
Vjen kulla e zezë pas meje si hije e zezë
si shpend i zi
bishë e zezë nga pyjet e errëta të mendimit
Shpirti im e sheh natën e trembet
prej kohësh kulla e zezë
nga thellësia e mosqenies*

*Prej kohe qëndron ajo kullë e zezë prej kohësh
kudo çmorit çapin për t'u kthyer
nga çdo anë e dritës
nga dejet nga brazdat nga ujvarat e pyjeve
nga rrëshketët e kuq të gjakut
të më shpëlajë zërin*

*Më duhej gjatë ta zbuloja atë
të shkoklohej lartësia pasha heshtja
e qeshura e zjarrit që i ndez kujtimet e hershme
nga të cilat pyjet digjen pëlçasin shkëmbenjtë
dhe deti shkrihet*

*Masakra të errëta vijnë nga thellësitë e njeriut
farëra të zeza ku mbin e rritet kulla e zezë
që të flaës me tjetër zë me t'errtin të saj
ajo që qëndron para fytyrës së vet
në pasqyrën e heshtjes dhe të errësirës*

*Gjersa hedh hapin ai
gjersa bashkë shkojnë
frika dhe hija e saj
pas ndriçimit shterpë të yjeve*

Përktheu: Fatos Arapi



FRANZ KAFKA, NJË MISTER LETRAR


Shkruante në formë të veçantë, jo lehtë të kuptueshme. Lexuesit nuk ishin të gjithë të kënaqur me ambiguitetin e teksteve të tij. Por, pikërisht ky stil specifik garanton aktualitetin e tij të pandërprerë.

Nga Kersten KNIPP

Ja ku shtrihet ai, njeriu i pafuqishëm. Kurrizi i fortë si një zhguall. Kur ngre kokën sheh barkun e tij të fryrë, të murrme dhe këmbët e tij të holla, mjerane, i shfaqen para syve të pafuqishme. A është ky trupi i një njeriu? Jo. Është trupi i një insekti gjigant. Një buburreci të pështirë, i cili mbrëmjen e kaluar ishte ende njeri. "Shndërrimi" quhet historia e Franz Kafkës e vitit 1912, rrëfimi ndoshta më i famshëm i tij. Një tekst i frikshëm, shqetësues, për cenueshmërinë e njeriut, pozitën e tij të pasigurt në botë, që brenda një nate mund ta kthejë në pozicion jashtë loje në shoqëri.

Por: përse e mbështjell Kafka historinë e tij me këtë tis misteri? A nuk mund të rrëfente edhe ndryshe? Në mënyrë "më realiste", "më të besueshme"? Disa nga lexuesit e tij i ka trazuar ky karakter misterioz. Kështu p.sh. edhe njëfarë Dr. Siegfried Wolff, i cili e lexoi rrëfimin menjëherë pas publikimit, dhe iu drejtua autorit, Kafkës. "Shumë i nderuar zotëri", i shkruante ai Kafkës, "ju më keni bërë të palumtur. Unë bleva 'Shndërrimin' tuaj dhe ia dhurova kushërirës sime. Por, ajo nuk arrin ta shpjegojë historinë. Kushërira ime ia dha mamasë së saj, por as ajo nuk diti ta shpjegojë... Vetëm Ju mund të më ndihmoni. Ju duhet ta bëni këtë pasi Ju jeni shkaktari i këtij shqetësimi. Pra Ju lutem më thoni se çfarë duhet të kuptojë kushërira ime nga 'Shndërrimi'."

Përse pra shkruan Kafka kaq errët, i vë personazhet e tij përballë situatash, të cilat në realitet nuk ekzistojnë, të paktën të marra fjalë për fjalë? Me këtë mënyrë të shkruarit Kafka ia vështirësoi punën vetes, pasi ajo u bë pengesë që ai të pëlqej si autor nga një publik i



• Manuskripti origjinal i "Procesit" të Kafkës në arkivin e letërsisë "Marbach"

gjerë, gjatë kohës që jetonte. Për gjuhëtarin Thomas Anz pranë Universitetit të Marburgut, i cili ka shkruar një studim kompakt mbi veprën dhe jetën e Kafkës, nuk përjashtohet që shkrimtari me anë të ndërtimit misterioz të teksteve të tij, riprodhonte në mënyrë formale realitetin e jashtëm. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për instancat shtetërore, të cilat i përshkruan në romane si "Proces" apo në formë shumë më të fortë tek tregimi "Kolonja e ndëshkimit".

Sipas Anzit mund të thuhet se Kafka në teksteve të tij ndodhitë

enigmatike që ia atribuon institucioneve si p.sh. gjykatave apo personave të respektit, i praktikon nga ana e vet tek lexuesit, duke ua bërë të vështirë të merren me teksteve të tij. "Ai pra u prezantohet lexuesve po aq i vështirë sa burokracia personazheve të tij. Ndoshta prapa kësaj qëndron diçka e tillë si pretendimi i vetë Kafkës për pushtet."

"Në teksteve të Kafkës", thotë gjuhëtarin Michael Braun, drejtor i shërbimit të letërsisë në fondacionin Konrad Adenauer, "shprehet nervozizmi i kohës së tij përballë fenomenit të modernizimit. Rritja

e qyteteve, mjetet e reja të transportit si hekurudha, e para së gjithash automobili, teknikat e reja të prodhimit dhe një aparat shtetëror në rritje – të gjitha këto ishin të reja dhe i trazonin njerëzit. Këtë trazim njerëzit e ndiejnë edhe sot. Për këtë arsye Kafka pranohet si profet, si dikush që i parapriu më 1900 realitetit të mesit të shekullit të kaluar e të mëvonshëm, si p.sh. njeriu i kontrolluar nga të gjitha anët apo njeriu i torturuar. Nga 'Kolonja e ndëshkimit' mund të kalosh direkt tek Guantanamo."

Njeriu nuk është asgjë në

botën moderne. Të paktën si person ai vlen pak. Në radhë të parë është e rëndësishme që e gjitha, pra shoqëria në përgjithësi të funksionojë. Ky besim gjeti shprehje ekstreme në lëvizjet totalitariste të shekullit XX: nacionalsocializmi dhe komunizmi. Por, edhe pse shtetet e organizuara në mënyrë demokratike e kanë zbutur disi këtë program të rreptë, p.sh. me programe sociale apo kanë zbutur mjaft sistemin e tyre juridik, ndjenja e pafuqisë së individit, e përshkruar nga Kafka, vazhdon të ekzistojë ende sot. Në mënyrë paradoksale, edhe shoqëritë në të cilat njerëzit gëzojnë liri të mëdha, mbartin një lloj tmerri. Fenomeni me të cilin është marrë vazhdimisht Kafka, i trazon njerëzit ende sot. Autoritetet pjesërisht shihen si kërcënuese, e pjesërisht vihen në lojë. E gjitha kjo shkakton mungesë orientimi. Këto janë përvoja të modernes, që vazhdojnë deri sot dhe të cilat një autor si Kafka i ka paraqitur në mënyrë të shkëlqyer dhe ekzemplare.

Për kuptimet e shumëfishta që vezullojnë në teksteve të Kafkës, ka edhe një arsye tjetër, shpjegon Michael Braun. Ajo gjendet në identitetin kompleks të Kafkës i cili është gjithashtu një fenomen i modernes. "Kafka ishte hebre, Kafka ishte avokat, Kafka ishte shkrimtar. Kafka vinte nga Praga, ai ishte çek dhe gjerman. Dhe të gjithë në këtë kompleksitet identitetesh të ndryshme atë Kafkë që flet me fjalë të qarta, do të mbetet me sa duket gjithnjë problem..

"Megjithatë, shton Braun, pikërisht ky problem i bën tërheqëse teksteve të Kafkës: "Nëse ky problem nuk do të ekzistonte, çfarë do të na shtynte të lexonim Kafkën?"



• Atdheu i Kafkës, Praga, rreth vitit 1893

Përktheu: Eliana Xhani

PSE PO LARGOHEN SERBËT NGA FSK?

Mbi 20 pjesëtarë serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës në mënyrë kolektive kërkuar që të largohen nga FSK. Këshilli i Sigurisë së Kosovës fajëson Beogradin. Reagon edhe ambasadori amerikan

Qeveria e Kosovës dhe prania ndër-kombëtare në Kosovë pjesë e QUINT-it janë të shqetësuar me "frikësimet", që po u bëhen pjesëtarëve të komunitetit serb, pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Sipas kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, presioni dhe frikësimi që po u bëhet atyre nga Serbia, po bën që këta pjesëtarë serbë të FSK-së të largohen nga kjo organizatë. Mbi 20 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga rajoni i Gjilanit, në mënyrë kolektive kanë parashtruar kërkesat për t'u tërhequr nga kjo forcë, për shkak të siç thuhet presioneve nga Beogradi, tha kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pas një mbledhjeje të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Sipas tij, "sulmet dhe shantazhet e Beogradit ndaj pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë bërë që këta të fundit, të kërkojnë lirim nga shërbimi në FSK".

MOTIVI I LARGIMIT: PRESIONI NGA BEOGRADI

"Raportohet edhe në media, për sulme me armë dhe mjete shpërthyes që e rrezikojnë jetën e



pjesëtarëve serbë të FSK-së. Këto në të kaluarën kanë ndodhur në veri, pastaj është raportuar edhe për kërcënime të tjera, por së fundi ka rezultuar me kërkesën për lirim të FSK-së nga një numër i pjesëtarëve serbë, nga një rajon i Kosovës, që nuk është veriu në këtë rast", tha kryeministri Haradinaj. Kryeministri tha se "shumica e tyre në deklaratimet e motiveve për lirim paraqesin presionin direkt të ushtruar nga autoritetet e Beogradit zyrtar".

"Presionet janë të natyrave të ndryshme, qoftë gjatë udhëtimeve në Serbi, ndalimi dhe marrja në pyetje, kërcënimet për jetën dhe për familjet e tyre e deri të instrumentet e tjera që janë përdorur, përfshirë edhe mekanizmat e tjerë të institucioneve paralele që operojnë në Kosovë", thotë kryeministri Haradinaj. Lidhur me këtë situatë të krijuar dhe pas kërkesës

së një grupi të pjesëtarëve serbë të FSK-së që të lirohen nga kjo forcë, reagoi në Twitter edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie.

FRIKËSIMI I SERBËVE, I PAPANUESHËM

"Frikësimi nga jashtë i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, është i papranueshëm. Diversiteti i FSK-së është një model për vendin. Ai duhet të kremtohet, e jo të shkatërrohet", shkroi në Twitter ambasadori amerikan. Një muaj më parë disa sulme mbi pronat e dy pjesëtarëve serbë të FSK-së, ndodhën në veri të Kosovës, autorët e të cilave nuk janë zbuluar akoma nga policia, megjithë hetimet që thuhet intensive. Të shqetësuar me këto sulme "që u duken si të koordinuara", mbi pronat e disa serbëve pjesëtarë të Forcës së Sigu-

risë së Kosovës (FSK), qenë shprehur edhe përfaqësuesit e listës "Srpska", e cila është pjesë e koalicionit qeveritar, mirëpo, që tash e një kohë nuk po marrin pjesë në mbledhjet e qeverisë. Goran Rakiq, kryetari i këtij subjekti politik, pati thënë se "institucionet e Kosovës po tregohen pasive karshi këtyre sulmeve ndaj serbëve në të gjithë territorin e Kosovës".

"Sulmet e fundit ndaj serbëve dhe pronave të tyre në territorin e Kosovës, edhe ndaj fëmijëve dhe grave, pasiviteti i institucioneve të Kosovës, mosndëshkimi i krimin dhe sjellja injoruese ndaj tyre, na kanë shtyrë që të fillojmë konsultimet me shtetin tonë dhe me presidentin Vuçiq", citojnë mediet lokale serbe Goran Rakicin. Lista Srpska që në kuvendin e Kosovës ka 10 deputetë, që deklaruar se largohet nga qeveria pas arrestimit nga policia për hyrje ilegale në Kosovë, të

shefit të zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Ky i fundit sipas mediave në Serbi, pati kërcënuar të gjithë serbët që duan të bëhen pjesë e ushtrisë së Kosovës. "Serbët të mos marrin pjesë në formimin e Ushtrisë së Kosovës, por të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe të merren me sigurinë e serbëve në Kosovë", pati thënë Marko Gjuriq, duke e cilësuar formimin e ushtrisë së Kosovës si një "formacion ilegal", në të cilin sipas tij, qytetarët serbë nuk do të duhej të merrnin pjesë.

NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS

Tash për tash, 10 % e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) përbëhet nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë, ndërsa, 2 për qind e kësaj force, përbëhet nga pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës. Autoritetet e Prishtinës vazhdimisht kanë deklaruar hapur synimin e tyre që FSK-në ta shndërrojnë në ushtri të Kosovës. Për ta bërë këtë duhet ndryshimi kushtetutës së Kosovës, për të cilën kërkohet edhe miratimi i deputetëve serbë në kuvendin e Kosovës, të cilat janë deklaruar disa herë që nuk do ta mbështesin me asnjë çmim formimin e ushtrisë së Kosovës.

Të ndodhur në këtë situatë, udhëheqësit e institucioneve të Kosovës thanë se shndërrimin e FSK-së në ushtri do ta bëjnë me një ligj të veçantë, që thuhet se do të ndodhë deri në fund të këtij viti. Mirëpo, që FSK-ja të shndërrohet në ushtri përmes një ligji dhe jo me ndryshime kushtetuese, nuk është e pranueshme për shtetet e QUINT-it. Ata thonë se Kosova ka të drejtë që ta ketë ushtrinë e saj, por kjo duhet të bëhet vetëm me ndryshimet e nevojshme kushtetuese.



Vendimi për vizat, para pushimit të verës

Komisioneri për zgjerim i BE-së, Johannes Hahn ka thënë se vendimi për liberalizim për Kosovën do të merret shumë shpejt. "Do ta mbajmë premtimin dhe do të

marrim vendim para pushimeve të verës", ka thënë Hahn i pyetur nga KTV-ja. Ai po merr pjesë në Samitin BE-Balkan Perëndimor që ka nisur sot në Londër.

Opozita e pakoordinuar për dialogun me Serbinë

Kuvendi i Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në funksion të arritjes së konsensusit për fazën finale të dialogut. Derisa partitë në pushtet janë pajtuar që në mungesë të konsensusit të gjerë ky proces t'i besohet presidentit Hashim Thaçi, opozita është duke kundërshtuar rolin prijës të presidentit për shkak të trashëgimisë së tij në dialog. Por ka mungesë uniteti edhe brenda kampit opozitar rreth dialogut, edhe pse të gjithë pajtohen që Kuvendi duhet ta thotë fjalën kryesore në këtë proces. Referuar praktikës së deritashme, njohës të rrethanave thonë se do të jetë vështirë arritja e një pajtimi para nënshkrimit të marrëveshjes eventuale mes Kosovës dhe Serbisë, rrjedhimisht



edhe vendosja e vijave të kuqe. "Asnjëherë në Kosovë nuk ka pasur konsensus të plotë në cilëndo fazë që ka nisur dialogu, por ka qenë votimi në Kuvend përmes të cilit më pas janë miratuar marrë-

veshjet. Pikërisht në mungesë të këtij konsensusi i kemi këto probleme. S'kemi platformë dhe dokument bazë, prandaj ka mungesë konsensusi", ka thënë analisti Ramush Tahiri.

MENDOJENI SIRINË TË PAKTËN DY MINUTA

Dr. Mehmet Oz u takua me sirianët që jetojnë në kampin e refugjatëve në Nizip të Gaziantepit në Turqi dhe në rajonin e Azezit në Siri

Kirurgu i famshëm turk i cili jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Dr. Mehmet Oz, theksoi se secili duhet të mbar të përgjegjësi në lidhje me Sirinë dhe Sirianët, ndërsa i bëri thirrje botës ta mendojë Sirinë "të paktën dy minuta". Nën organizimin e Drejtorisë Turke për Menaxhimin e Katastrofave dhe Emergjencave (AFAD), Oz u takua me sirianët që jetojnë në kampin e refugjatëve në Nizip të Gaziantepit në Turqi dhe në rajonin e Azezit në Siri. Duke folur për Anadolu Agency (AA), Oz tha se gjatë vizitës së tij ka përjetuar ndjenja të ndryshme dhe ka ngelur i habitur në disa çështje, ndërsa ka ngelur mjaft i prekur nga rrëfimet e refugjatëve sirianë. Oz beson se për



çdo njeri ekziston diçka që mund të bëhet për refugjatët sirianë dhe Sirinë. "Lufta është e dhimbshme, por nëse humbin brezin pas luftës, atëherë ky është gabim i ynë", tha Oz.

Mjeku me famë botërore tregoi përvojën e tij të njohjes me një vajzë me emrin Betul gjatë vizitës. "E pyeta se çfarë mendonte kur përballëj me vuajtje. Ishte vajzë 12 vjeçe. Gjashtë vite më parë kishte ikur nga Siria, pasi shtëpia e tyre

ishite bombarduar. Në pyetjen time ajo u përgjigj se gjithnjë kërkon nga shokët e saj të qeshin. E pyeta se si një gjë e tillë është e mundur. 'Nuk kemi zgjidhje tjetër', më tha. Ishte vetëm 12 vjeçe, ndërsa ofroi një leksion jete. Të gjithë duhet të marrim mësim nga kjo", u shpreh Oz. Ai është i mendimit se disa qarqe nuk i kanë përmbushur premtimet e tyre në lidhje me Sirianët.

"Një pjesë e shteteve të botës mbështet këto punime, ndërsa një

pjesë nuk mban premtimet. Unë them se të gjithë që më dëgjojnë duhet të ulen dhe të mendojnë dy minuta se çfarë mund të bëj unë. Le të bëjmë diç, qoftë edhe gjë e vogël.

Dërgo letër, dërgo top futbollit, ose dërgo një shënim të vogël. Nis një fushatë në rrjetet sociale. Ndihamat e vogla ndonjëherë mund të japin shpresa të mëdha. Mendojeni Sirinë dy minuta", theksoi kirurgu turk Mehmet Oz.



Jep dorëheqje sekretari i Brexitit

David Davis ka dhënë dorëheqjen si sekretar britanik i shtetit për daljen e vendit të tij nga Bashkimi Evropian (BE). Dorëheqja e sekretarit të Brexit-it pason pas tensioneve në rritje në kabinetin e kryeministres britanike, Theresa May, mbi vizionin e saj për marrëdhëniet me BE-në pas Brexit-it. Davis gjithashtu u përplas me kryeministren May mbi planin e saj të Bashkimit Doganor me BE-në që do të mbante Mbretërinë e Bashkuar të afërt me BE-në kur është fjala për tregtinë. Kryeministrja May dështoi të bashkonte kabinetin e saj në vizionin e saj "të tretë" për një "Brexit të butë" në një takim në rezidencën e saj private në Chequers. Megjithatë kabineti i saj ka rënë dakord për këtë vizion "të tretë", ka shenja të rritjes së kundërshtimit mes mbështetësve të Brexit-it në partinë e saj, pasi ata nuk pajtohen me planet e saj për një "Brexit të butë".



Japoni, 100 të vdekur nga moti i keq

Është rritur në të paktën 100 numri i të vdekurve nga shirat e fortë që kanë goditur Japoninë perëndimore. Lajmin e bën të ditur qeveria japoneze. Është konfirmuar tashmë vdekja e 87 personave, ndërkohe që 13 të tjerë të gjetur dje nuk kanë dhënë shenja jete. Janë ende 68 të humbur, kryesisht në zonën e Hiroshimës.

Qindra fëmijë në gjykata duke pritur bashkimin me familjen



Në mesin e qindra fëmijëve të ndarë nga prindërit e tyre në Amerikë, qëndron edhe një djalosh 1 vjeçar që pret radhën e tij në gjykatë, për vendimin për ribashkim me familjen e tij. Ndarja e fëmijëve migrantë nga prindërit e tyre u bë pas politikave të krijuara nga administrata e Trump që kanë zero tolerancë. Këto ndarje i kanë dhënë një hije të keqe admini-

stratës së Trump duke bërë që të gjitha mediat të raportojnë për këtë çështje me fotografi të fëmijëve që qajnë pa prindërit e tyre. Kritikët po ashtu kanë akuzuar gjykatën e migracionit për sistemin gjyqësor që detyron fëmijët - edhe ata nën 1 vjeç, të paraqiten në gjykatë për të kaluar nëpër proceset e deportimit, të ndarë nga prindërit e tyre.

Vdes gruaja britanike që i ishte ekspozuar Noviçokut

Policia britanike ka njoftuar për vdekjen e një gruaje që ishte sëmurë, pasi i ishte ekspozuar agjentit nervor, Noviçok, afër vendit ku ishte helmuar me po të njëjtën substancë, ish-agjenti rus, Sergei Skripal dhe vajza e tij, Yulia. Policia e Londrës ka thënë përmes një deklarate se Dawn Sturgess, 44 vjeçare, nënë e tre fëmijëve, ka vdekur në spital më 8 korrik, pasi i ishte ekspozuar Noviçokut. Policia po ashtu ka thënë se vdekja tani është duke u hetuar si vrasje. Krye-

ministrja britanike, Theresa May ka thënë se është e "shokuar" për vdekjen e Sturgess. "Polica dhe zyrtarët e sigurisë janë duke punuar me urgjencë për të zbuluar faktet e këtij incidenti, i cili tashmë po trajtohet si vrasje", ka thënë ajo në Twitter. Udhëheqësi i sektorit kundërterrorizëm në Britani, Neil Basu, e ka cilësuar lajmin për vdekje si "shokues dhe tragjik". "Dawn ka lënë mbrapa familjen e saj, duke përfshirë tre fëmijë andaj mendimet dhe lutjet tona

janë me ata, në këtë periudhë jashtëzakonisht të vështirë", ka thënë ai. Autoritetet britanike kanë thënë se Sturgess dhe i dashuri i saj 45 vjeçar, Charlie Rowley, ishin gjetur pa ndjenja në Eimsbëri më 30 qershor, më pak se 20 kilometra nga Sallsbëri, vend ku ishin helmuar Skripalët në muajin mars. Rowley vazhdon të jetë në gjendje kritike në spital. Policia është duke vazhduar të hetojë rreth asaj se si dy personat i janë ekspozuar toksinës.



SMARTI SHËNON 20 VJETORIN E EKZISTIMIT

Para dy dekadave në rrugë është shfaqur gjenerata e parë e modelit Smart, e cila është ideuar nga Mercedesi. Prodhimi i Smartit ka filluar në vitin 1998, por ideja për një veturë të tillë, të vogël për qytet, ishte projektuar qysh në fillim të viteve 70-a. Mercedesi këtë projekt në atë kohë e quante "veturë se së ardhmes", ndërsa skicat e para të vitit 1972 kanë prezantuar një veturë ultra-kompakte me një gjatësi prej vetëm 2.5 metra.

Drejtuësit e kompanisë, kishin konstatuar se ideja është "mbresëlënëse", por që atë kohë ishte teknikisht pamundur, sepse ky model nuk plotësonte standardet e nevojshme të sigurisë. Megjithatë, inxhinierët kanë vazhduar të zhvillojnë një ide tjetër edhe në vitin 1980, por ende ishin larg realizimit të këtij automjeti. Në vitin 1993, para anëtarëve të Komitetit Drejtues të Mercedesit janë prezantuar konceptet Eco Sprinter dhe Eco Speedster. Këta anëtarë janë ndarë të kënaqur me atë që kanë parë dhe më pas kanë dhënë dritën jeshile për zhvillimin të mëtejshëm të këtyre dy modele.

Gjithashtu, për këtë lloj veture është interesuar edhe prodhuesi i njohur i orëve—Swatch, themeluesi i së cilës është Nicolas G. Hayek. Ai kishte plane për një veturë të



Përveç motorëve benzinë dhe dizel, Smart që nga gjenerata e dytë ka ofruar edhe versionin elektrik dhe ky trend ka vazhduar edhe te modeli më i ri. Planifikohet që Smarti në një të ardhme të afërt të prodhohet dhe të shitet vetëm në version elektrik

vogël urbane qysh nga viti 1989, përcjell Koha.net. Nga ky partneritet [Mercedes dhe Swatch], është krijuar kompania Mico Compact Car AG, ndërsa lokacioni në të cilin do të zhvillohej prodhimi është zgjedhur Hambah, në Francë, afër kufirit me Gjermaninë. Zhvillimi në këtë model serik ka filluar në vitin 1994, ndërsa Smarti i parë është prezantuar para publikut të gjerë në panairin e veturave në Frankfurt në vjeshtën e vitit 1997. Prodhimi i tij ka filluar një vit më vonë, më 2 korrik të 1998-ës, ndërsa në vitin e njëjtë në muajin tetor veturat e para u janë shpërndarë pronarëve.

Në vitin 2000, është shfaqur versioni kabrio i Smartit, ndërsa tri

vjet më vonë janë shfaqur edhe versionet Roadster dhe Roadster Coupe. Familja e modelit Smart është zgjeruar në vitin 2004 me versionin ForFour, me katër dyer, i cili është krijuar në bashkëpunim me kompaninë e njohur japoneze Mitsubishi. Megjithatë, ky version ka qëndruar në treg vetëm dy vjet, ku në vitin 2006 është ndërprerë prodhimi i tij. Smart ForFour është rishfaqur në vitin 2014, atëherë kur është lansuar edhe gjenerata aktuale e modelit Smart.

Ndërkaq në vitin 2007, është prezantuar gjenerata e dytë e modelit Smart ForTwo, transmeton Koha.net. Ky model ishte pak më i madh dhe më komfort për dallim

nga paraardhësi i tij, ndërsa në vitin 2008 është shfaqur për herë të parë në SHBA. Gjenerata aktuale e modelit Smart është shfaqur pas 7 vjetësh, së bashku me Smart ForFourin e ri, si dhe shumë shpejtë pas këtyre është shfaqur edhe versioni kabrio. Përveç motorëve benzinë dhe dizel, Smart që nga gjenerata e dytë ka ofruar edhe versionin elektrik dhe ky trend ka vazhduar edhe te modeli më i ri. Planifikohet që Smarti në një të ardhme të afërt të prodhohet dhe të shitet vetëm në version elektrik. Fjala është për tregun europianë nga viti 2020. Për 20 vjetet e ekzistimit të Smartit, janë shitur mbi 2.2 milionë vetura me etiketën e këtij prodhuesi.



iPhone i palosshëm, disa vite larg arritjes

Kur shfaqet koncepti i një smartfoni me ekran të palosshëm, me shumë gjasë mendohet për Samsungun. Megjithatë, duket se gjatë viteve të fundit, Apple është kompania e cila po fillon ngadalë të merret me telefona të palosshëm pasi disa analistë besojnë se kjo kompani mund të punojë në një pajisje të tillë.

Por, nëse keni pritur që të shihni një iPhone të tillë së shpejti atëherë duhet të prisni, pasi një raport nga Korea Times, i cili citon një burim të paidentifikuar të kësaj industrie, thotë se një pajisje e tillë mund të jetë shumë vite larg nga të qenit realitet. "Apple po përpqet të lansoj iPhone të rinj me karakteristika të avancuara vitin e ardhshëm si dhe është duke shqyrtuar që të zhvillojë iPhone të palosshëm, të cilat do të arrijnë disa vjet më vonë", citohet ky burim. Gjithashtu, raportohet se kjo pajisje mund të lansohet në vitin 2020, por sipas raportit të ri mund të vonohet më shumë se aq. Po ashtu, spekulohet se iPhone i palosshëm mund të jetë rezultat i partneritetit të Apple me LG-në në vend të Samsungut. Të dytë, LG dhe Samsung thuhet se janë duke zhvilluar ekrane të tilla, dhe më herët këtë vit LG prezantoi një prototip të ekranit OLED të palosshëm.



Samsung pëson rënie të shitjeve

Samsung ka pasur shitje rekorde e profit të madh përgjatë shtatë tre muajorët e fundit, por kjo si duket ka përfunduar. Gjiganti korean ka publikuar fitimet gjatë 3 muajorët të dytë të 2018-ës, ku ka treguar se nga shitjet ka përfituar 52 miliardë dollarë, ndërsa fitimi operativ i konsoliduar duhet të jetë rreth 13.25 miliardë dollarë. Fitimet e Samsung kanë rënë krahasuar me tre muajorin e parë të 2018-ës, ku shitjet ishin 56.2 miliardë dollarë e fitimet operative kishin shënuar rekord, me 14.5 miliardë dollarë. Sipas analistëve, arsyeja e rënies së profitit janë shitjet e dobëta të Galaxy S9. Përdoruesit e smartfonëve nuk kanë qenë të impresionuar nga risitë që ka sjell kjo pajisje e re.

Nesër prezantohet Nokia 5.1 Plus

Modeli më i ri i telefonit Nokia 5.1 Plus do të prezantohet më 11 korrik në Kinë, ku modeli me 32 GB memorie të brendshme do të ketë një çmim prej rreth 120 dollarë, ndërsa versioni 64GB do të kushtojë rreth 150 dollarë. Kur vjen puna te çmimet, duhet të kihet parasysh se ato me siguri do të ndryshojnë dhe rriten sapo telefoni të lëshohet për tregun global. Nokia më i ri do të ketë një prerje në ekranin prej 5.86 inç me rezolucion 720p1520x, procesor Snapdragon 600 ose Helio P60, me 3GB, 4GB dhe 6GB RAM, si dhe 32GB ose 64GB hapësirë të ruajtjes. Pajisja do të ketë dy kamera në anën e pa-



sme 13MP + 5MP, ndërsa kamera e përparme ka një sensor 8MP. Çdo gjë është mundësuar nga bateria 3000 mAh. Duhet të theksohet se

këto janë informata të rrjedhura dhe se duhet të merren me një dozë rezervë derisa telefoni të paraqitet zyrtarisht.

Skanerët e ardhshëm për gishta do të matin pulsën dhe temperaturën

Një grup ekspertësh nga Koreja e Jugut njoftoi se kanë zhvilluar një sensor fleksibil dhe transparent të gjurmëve të gishtërinjve për pajisjet mobile që mund të masë presionin dhe temperaturën. Sensorët e gjurmëve të gishtave janë një mënyrë shumë popullore për njohjen biometrike të përdoruesve në pajisjet mobile dhe laptopë. Teknologjia e fundit është veçanërisht interesante nëse mund të kombinohet me zbulimin e shkencëtarëve të Koresë së Jugut në të ardhmen. Ky ekip, në fakt, ka zhvilluar një lexues gjurmë gishtë-

rinjsh që është fleksibil dhe transparent - dhe pavarësisht nga ajo që mund të lexohet nga kreshtat e lëkurës është në gjendje të njëjtën kohë të regjistrojë presionin dhe temperaturën në gisht. Me këto karakteristika të reja, sensorët bëhen shumë më të sigurt, pasi mund të mashtrohen më vështirë nga metoda të ndryshme të kopjimit të gjurmëve të gishtërinjve. Teknologjia është testuar dhe, siç thonë krijuesit e saj, cilësia e leximit dhe zgjidhjes së gjurmëve të gishtërinjve i plotëson standardet e vendosura nga FBI.



"Bëhet fjalë për një ekip serioz me një bagazh të madh të ndeshjeve të Ligës së kampionëve dhe Liga Evropës si dhe janë shtatë herë kampion të Uellsit. Do të isha i kënaqur me fitore pa pranuar gol", pohon trajneri Osmani

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 9 korrik - Skuadra e Shkëndijës do të jetë skuadra e parë nga Maqedonia e cila do të startojë me ndeshjet e kompeticionit evropian. Në kuadër të ndeshjes kualifikuese të Ligës së kampionëve, kuqezinjtë sonte me fillim në ora 20.15, në stadiumin "Filipi i dytë" do të përballen me skuadrën nga Uellsit "The New Saints". Trajneri Qatip Osmani për këtë ndeshje tha se punës i janë qasur seriozisht dhe se dëshiron fitore pa pranuar gol. "Kemi realizuar një fazë të suksesshme përgatitore dhe kjo më jep mua dhe lojtarëve shpresë se jemi të përgatitur për sfidën me TNS-në. E dimë se për këtë sfidë nuk do ta kemi në dispozicion Ferhan Hasanin, lojtarin vendimtar. Por, edhe në të ardhmen kanë ndodhur këto gjëra. Mendoj se në ndeshjet kontrolluese që i kemi zhvilluar, mendoj se atë pozitë e kemi mbuluar mirë. Andaj mund të them se në vend të tij do të luajë Izair Emini. Kemi analizuar mirë kundërshtarin, i cili luan me një sistem 4-3-3, por kur mbrohen, formacioni i tyre transformohet në 5-4-1. Kështu kanë luajtur vitin e kaluar kundër Rjekës, por tani nuk e kanë sulmuesin i cili ka qenë lojtari kryesor. Gjithashtu bëhet fjalë për një ekip serioz me një bagazh të madh të

LIGA E KAMPIONËVE, SHKËNDIJA PRET SKUADRËN NGA UELLSI, TNS

OSMANI DHE ALIMI DËSHIROJNË FITORE PA PRANUAR GOL



Qatip Osmani

E dimë se përballja e sotme luhet në një termin kur luhet gjysmëfinalja mes Francës dhe Belgjikës në kuadër të Kampionatit Botëror 'Rusi 2018', por jam i sigurt se ata të cilët e duan Shkëndijën, do të vijjnë në stadium dhe do ti përkrahin futbollistët

Katër gazetar dhe rreth 20 tifoz, kryesisht familjar dhe miq të futbollistëve të Uellsit, do të jenë prezent sonte në stadiumin "Filipi i Dytë" në Shkup, të cilët do të përkrahin ekipin e tyre të zezërës ndaj skuadrës tetovare, njoftuan nga klubi tetovar. Derisa, nga dje, në Maqedoni gjendet kryetari i klubit Majk Haris, i cili për këtë ndeshje ka udhëtuar me automobil. Ai dje është fotografuar para stadiumit "Filipi i dytë", duke paralajmëruar kështu sfidën e sotme me Shkëndijën



"Na pret një ndeshje e vështirë, por ne kemi zhvilluar përgatitje të mira dhe besojmë në sukses. Dëshiroj fitore pa pranuar gol, kjo do të ishte më ideale. Sa i përket shiritit të kapitenit, për mua kjo është një përgjegjësi dhe njëkohësisht nder i madh", deklaroi Alimi.

Ndërkohë, trajneri Osmani zbuloi edhe formacionin me të cilin do të kundërvihet uellsianëve, derisa në stërvitjen e djeshme zyrtare, stafi është dashur të vendos se a do të luajë apo jo futbollisti dhe golashënuesi më i mirë i ekipit, Besart Ibraimi, i cili është i lënduar. Në rast se nuk do të jetë në dispozicion të luajë Ibraimi, në vend të tij do të jetë Shefiti. Formacioni: Zahov, Bejtullai, Musliu, Adili, Murati, Alimi, Taipi, Radeski, Emini, Zhunior, Ibraimi (Shefiti)

ndeshjeve të Ligës së kampionëve dhe Liga Evropës si dhe janë shtatë herë kampion të Uellsit. Do të

isha i kënaqur me fitore pa pranuar gol", deklaroi para gazetarëve trajneri i Shkëndijës. Ndryshe, fito-

re pa pranuar gol dëshiron edhe Armend Alimi, i cili njëherit do të jetë edhe kapiteni i ri i Shkëndijës.

Khaka drejt kampionatit spanjoll



Taulant Xhaka mund të largohet nga Bazeli pas një kohe të gjatë. Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë ka pasur një vit të mirë me Bazelin edhe pse në fund të stinorit ishte i lënduar. Por duket

se ai po i kalon momentet e tija të fundit si futbollist i gjigantit zviceran Basel. Sevilja së fundmi ka blerë nga Bazeli portierin çek Tomas Vaclik, por blerjet tek skuadra e madhe zvicerane nuk përfundojnë këtu.

Finalistët e Kupës së Spanjës janë duke tentuar transferimin e Taulant Xhakës nga Bazeli. Klubi spanjoll është në kërkim të një mesfushori defensivë dhe sipas mediave spanjolle Xhaka mund të jetë lojtari. Sevilja ka kërkuar te Bazeli informacione për Xhakën dhe bisedimet mes klubeve tani kanë filluar. Besohet se klubi spanjoll është gati t'i ofrojë rreth katër milionë euro Bazelit për Xhakën. 27-vjeçari ka kontratë me Bazelin deri në vitin 2021, ndërsa më parë ka luajtur vetëm për Grass'hopperin për një stinor si i huazuar.

MUAREM FLET PARA SFIDËS ME GLLAZGOU REXHER

Nuk shkojmë për tu mbrojtur, por për rezultat pozitiv

Shkup, 9 korrik - FC Shkupi ka hyrë në fazën përfundimtare para sfidës së parë eliminatorie në kuadër të Ligës Evropë, kundër Gllazgo Rexthers, e cila më 12 korrik do të zhvillohet në Skoci. Përgatitjet në Turqi u shfrytëzuan maksimalisht për të akumuluar forcën dhe për të dhënë mundësi secilit futbollist që të dëshmojë formën aktuale. Mesfushori Muarem Muarem beson se kjo fazë që është kaluar me mjaft sukses, pasi pjesa kryesore ka qenë fakti se janë shmangur lëndimet serioze. "Me rëndësi është që nuk kishim lëndime dhe kjo është me shumë rëndësi, sepse pas Ligës Evropë, pas 15 ditëve fillon edhe kampionati vendor. Për një trajner është me rëndësi që ekipi të jetë shëndosh dhe kujt do ti jep shans të sh-

frytëzojë në fushë", tha në fillim Muarem. Sipas mesfushorit ofensivë, kundërshtari i ardhshëm në skenën evropiane, Glasgow Rexthers ka një bagazh të madh të sukseseve në garat evropiane dhe në këtë sezon drejtohet nga një emër i madh në futbollin britanik si Stiven Xherrard. Sipas Muarem, FC Shkupi hyn në këtë duel pa asnjë ngarkesë. "Ata kanë një histori shumë të fortë, por si ekip nuk e di se si janë tani, pasi që e di se disa vite në të kaluarën ishin edhe në Divizionet më të ulëta, mirëpo e di se edhe ata kanë një ekip të ri. Ne si ekip nuk kemi se çka të humbin, do të shkojmë atje të luajmë futboll dhe do të provojmë të kalojmë më tej. Thjesht nuk shkojmë për të humbur, shkojmë për rezultat të mirë", deklaroi Muarem Mu-



rem. Ndërkohë, bardhekaltërit, po stërviten në Shkup, ndërsa sot (e martë) ekspedita do të bëhet gati për udhëtimin drejt Glasgouit në Skoci.

Në bazë të nenit 126nga Ligji për ndërrime dhe plotësime për arsim fillor („Gazeta zyrtare e RM” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010,dhe 67/2017) dhe Vendimit të kryetarit të Komunës së Dibrës nr. 09-575/2nga 03.07.2018,Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur me datë 04.07.2018 sjell vendim për:

SHPALLJE

për zgjedhjen të drejtorit të shkollës SHFK Bashkim Vëllazërim Dibër

Kandidatët të cilët do të aplikojnë në shpallje duhet krahas kërkesave të përgjithshme të parapara me Ligj,duhet të plotësojnë edhe këto kushte:

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj,kandidatët duhet t,i plotësojnë edhe këto kushte: Kandidatët e paraqitur me lutjen dhe biografinë e shkurtër,duhet ti dorëzojnë edhe këto dokumente:

- Ti plotësoje kushtet për arsimtar,pedagog ose psikolog në arsimin fillor
 - Diplomën për arsimin e lartë të kryer;
 - Vërtetim për përvojën në punë në institucionet edukativo-arsimore të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe shkencës (së paku 5 vjet);
 - Vërtetim për dhënien e provimit profesional (për personat të cilët janë të detyruar ta japin);
 - Certifikatë për dhënien e provimit për drejtorë;
 - Certifikatë e nënshtetësisë;
 - Certifikatë mjekësore
 - Certifikatë përkatëse,jo më të vjetër se pesë vjet,për njohje të gjuhës angleze „TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS-së paku 3 pikë, BULATS-së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English)-të dhënë, APTIS-së paku niveli A2;
 - Vërtetim për dhënien e testit psikologjik dhe testit për integritet;
 - Vërtetim se në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënime ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit,detyrës ose veprimtarisë.
 - Paga bazë 26,500.00 den.
 - Orari i punës do të jetë paradite
- Shpallja do të jetë e hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të bëhet në afat prej 10 ditëve nga dita e dorëzimit të promovimit për zgjedhje nga Këshilli i shkollës.

Dokumentet të cilat nuk dorëzohen në kohe dhe të pakompletuara,nuk do të merren parasysh.
SHFK Bashkim Vëllazërim Dibër

Në bazë të nenit 89-a nga Ligji për ndërrime dhe plotësime për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 6p.67/2004,100/2012,24/2013 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017) dhe Vendimit të kryetarit të Komunës së Dibrës nr. 09-574/2 nga 03.07.2018, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur me datë 09.07.2018 sjell vendim për:

SHPALLJE

Për zgjedhjen të drejtorit të shkollës Q.A.M.O. "Zdravko Çoçkovski" Dibër

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj,kandidatët duhet t,i plotësojnë edhe këto kushte: Kandidatët e paraqitur me lutjen dhe biografinë e shkurtër,duhet ti dorëzojnë edhe këto dokumente:

- Ti plotësoje kushtet për arsimtar,pedagog ose psikolog në arsimin e mesëm
 - Diplomën për arsimin e lartë të kryer;
 - Vërtetim për përvojën në punë në institucionet edukativo-arsimore të verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe shkencës (së paku 5 vjet);
 - Vërtetim për dhënien e provimit profesional (për personat të cilët janë të detyruar ta japin);
 - Certifikatë për dhënien e provimit për drejtorë;
 - Certifikatë e nënshtetësisë;
 - Certifikatë mjekësore
 - Certifikatë përkatëse,jo më të vjetër se pesë vjet,për njohje të gjuhës angleze „TOEFEL IBT-së paku 30 pikë, IELTS-së paku 3 pikë, BULATS-së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English)-të dhënë, APTIS-së paku niveli A2;
 - Vërtetim për dhënien e testit psikologjik dhe testit për integritet;
 - Vërtetim se në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënime ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit,detyrës ose veprimtarisë.
 - Paga bazë 28,800.00 den.
 - Orari i punës do të jetë paradite
- Shpallja do të jetë e hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të propozimit për zgjedhje nga Këshilli i shkollës.

Dokumentet të cilat nuk dorëzohen në kohe dhe të pakompletuara,nuk do të merren parasysh.
Q.A.M.O. "Zdravko Çoçkovski" Dibër

Në bazë të nenit 172 dhe 176 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe nenit 9, 10 dhe 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/13), me propozim të Këshillit mësimor-shkencor-vendimi nr. 02-528/3 të datës 4.7.2018, Dekani i Fakultetit të shkencave bujqësore dhe ushqimit-Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, publikon

KONKURS

1. (një) mësimdhënës në sferën shkencore kimi – 10700 Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave
2. 1 (një) mësimdhënës në sferën shkencore pedologjia – 40100 Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave
3. 1 (një) mësimdhënës në sferën shkencore ujitje – 40110 Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave
4. 2 (dy) mësimdhënës në sferën shkencore pemëtaria – 40500 Klasifikim i sferave, fushave dhe disiplinave

Kushtet: Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme të cekura në nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe kushtet e posaçme në pajtim Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/13).

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje, biografi të shkurtër, deklaratë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumente me të cilën dëshmohet përmbushja e kushteve.

Dokumentet të parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Vendi i punës së mësimdhënës është përcaktuar në pajtim me aktet e fakultetit dhe orarit të orëve në semestër.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e plotë dorëzohen deri në Fakultetin e shkencave bujqësore dhe ushqimit – Shkup, bul. “16-ta Makedonska Brigada” nr. 3 Shkup.

Afati për paraqitje është 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË BUJQËSISË DHE USHQIMIT - SHKUP
UNIVERSITETIT “SHËN KIRILI DHE METODI” NË SHKUP

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, truall i parë në “Momin Potok” – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr 167/2015, 27/2016 dhe 120/2018) dhe nenit 5, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA Elektranat e Maqedonisë, në pronësi të shtetit Shkup, ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën për lidhje të marrëdhënies së punës nr. 04-3695/1 të datës 09.07.2018

SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË – SHKUP

publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës në Drejtorinë e SHA ELEM – Shkup, për realizimin e punëve për kohë të pacaktuar, për vendet e punës në vijim:

- 3 (tre) realizues në vendin e punës “Mirëmbajtës të higjienës” në Shërbimin për punë të përgjithshme, në Sektorin për punë juridike dhe të përgjithshme.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: Shkalla I, Arsim fillor.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 16.988 denarë.

- 1 (një) realizues në vendin e punës “Referent përgjegjës për korrespondencë dhe përgatitje të dokumentacionit tenderues për tenderë ndërkombëtare”, në Shërbimin për procedura ndërkombëtare, përcjellje të marrëveshjeve, financim dhe përpilim të analizave investuese, në Departamentin për investime, në Sektorin për zhvillim dhe investime.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: Shkalla VII, Fakulteti filologjik, gjuhë angleze ose gjuhë gjermane, Fakulteti juridik ose ekonomik, njohje të gjuhës angleze ose gjermane, 1 vjet përvojë pune.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 35.863 denarë.

- 1 (një) realizues në vendin e punës “Referent përgjegjës për përpilim të marrëveshjeve për furnizime publike” në Shërbimin për furnizime të përbashkëta, në Departamentin për furnizime të përbashkëta, në Sektorin për punë komerciale.

Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim: Shkalla VII, Fakulteti juridik, 2 vjet përvojë pune.

Shuma në të holla e pagesës bazë është 38.083 denarë.

Java e punës është 5 (pesë) ditë pune, nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditëve të punës do të zgjasë 8 orë në ditë edhe atë me fillim prej ora 07:30-08:00 deri në ora 15:30-16:00.

Shpallja zgjatë tre ditë pune nga dita e shpalljes.

Së bashku me fletëparaqitjen (në të cilën theksohet se për cilin vend pune konkurrohet), kandidatët duhet të parashtrijnë:

- Dëshmi për arsimin e mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM);
- Certifikatë të shtetësisë (kopje);
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM), për vendin e punës për të cilin kërkohet;
- Dëshmi për njohje të gjuhës angleze ose gjuhës gjermane, për vendin e punës për të cilin kërkohet;
- Biografi të shkurtër në gjuhën maqedonase;
- Kontakt telefon.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme, nga të cilat shihet se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të dorëzohen në adresën:

SHA Elektranat e Maqedonisë - Shkup, Drejtoria

rr. 11 Oktomvri nr. 9, Shkup, (me shenjë “për shpallje publike”).

SHA ELEM - Shkup

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 82/18), dhe nenit 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 274/13 – teksti i pastruar), Fakulteti matematiko-natyror në Shkup, shpall

KONKURS

për zgjedhje të titujve mësimor-shkencor, titullar dhe bashkëpunues

INSTITUTI PËR BIOLOGJI

1. Zgjedhje të një asistenti për grupin e lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: biologjia molekulare dhe gjenetika.

Afati për zgjedhje është për kohë prej tre vjet.

INSTITUTI PËR KIMI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: kimia organike dhe biokimia.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

2. Zgjedhje të një profesori titullar me korrespondencë për grupin e lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: kimia organike dhe biokimia.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

OBSERVATORI SIZMOLOGJIK

1. Zgjedhje të dy bashkëpunëtorëve shkencor të grupit të lëndëve nga sfera mësimore-shkencore: sizmologjia dhe fizika dhe brendësia e tokës.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/18), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistent-doktorues të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (Lajmëtarit universitar nr. 274/2013 tekst i pastruar) si dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Shuma në të holla e pagesës fillestare të mësimdhënësit është 31.050,00 denarë në neto shumë, e bashkëpunëtorit është 28.980,00 denarë në neto shumë, ndërsa për asistentin është 22.425,00 denarë në neto shumë. Paga fillestare mund të jetë e ndryshueshme.

Orari i punës është caktuar në pajtim me kalendarin studentor dhe orarin e orëve të Fakultetit.

Procedura pas konkursit mund të zgjatë më së shumti gjashtë muaj.

Në Arkivin e Fakultetit kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, dokumentet e nevojshme për shkallën e arsimit (një ekzemplar origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter), vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (në katër kopje), biografi të shkurtër (në katër kopje), formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencore dhe titujt mësimor-profesional (merret në fakultet), certifikatë të shtetësisë (në katër kopje), dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënime ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.

Për informata të tjera në lidhje me Konkursin kandidatët mund të drejtohen në Sekretariatit e Fakultetit matematiko-natyror në Shkup.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit Matematiko-Natyror në Shkup, rr “Arhimedova” nr. 3, 1000 Shkup.

UNIVERSITETI “SHËN KIRILI DHE METODI”- SHKUP
FAKULTETI MATEMATIKO-NATYROR - SHKUP

SIPAS "MUNDO DEPORTIVO"

PSZH OFRON 270 MLN EURO PËR KUTINJON

Parisienët janë hedhur në sulm për ish lojtarin e Liverpoolit për të cilin janë të gatshëm t'i ofrojnë Barcelonës plot 270 milionë euro një shifër rekord kjo, me Barcelonën që 6 muaj më parë firmosi me lojtarin për 110 milionë euro plus bonuset. Vështirë se Barcelona do të privohet nga një tjetër yll megjithatë kur bëhet fjalë për PSG asgjë nuk është e pamundur

"Mundo deportivo" ka raportuar se Paris Sen Zhermen ka gati një ofertë për Barcelonën në vlerën e 270 milion euro për të blerë shërbimet e Philippe Kutinjo. Edhe pse Barça ka pohuar se nuk ka asnjë ofertë në tavolinë ka raportuar se ylli brazi-



lian nuk është në shitje. Nëse ai vendos vetë të largohet atëherë klubi parisien duhet të paguajë klauzolën prej 400 milion eurosh. Kjo nuk është hera e parë që PSZH-ja vihet në lëvizje për Kutinjon. Në fillim të janarit kur ish-futbollisti i Liverpoolit e kishte mbyllur paraprakisht transferimin e tij tek

Barcelona, PSZH futi hundët duke u përpjekur që t'ia "rrëmbente" në minutën e fundit katalanasve. Kjo ofertë sipas asaj që raporton "Deportivo" vjen pasi me transferimin i brazilianit është e vetmja mënyrë që mund të bind Nejmari që të vazhdojnë ty qëndrojnë tek kampionët francez. PSZH-ja

është në "kërcënim" të hapur nga Real Madridi aq më tepër tani që Cristiano Ronaldo është drejt largimit dhe klubi i bardh ka në shënjestër Nejmari dhe Mbappe për zëvendësimin e portugezit. Kështu që nënshkrimi i Kutinjos do të shërbejë PSZH-së për të mbërthyer edhe Nejmari.

Shtatë ditë afat për të mbyllur nënshkrimin e Ronaldon

Juventus pret që të mbyllë marrëveshjen me Cristiano Ronaldo në një maksimum prej shtatë ditësh. Ky lajm është bërë publik në programin "Tiempo de Juego" ka raportuar "Mundo deportivo". Ky program ka siguruar gjithashtu se Real Madridi ende nuk ka marrë ndonjë ofertë nga ekipet italiane apo ndonjë tjetër për

KR7. Pavarësisht kësaj gjatë ditë së djeshme "Sport Mediaset" publikoi se të martën më 10 korrik do të bëhet zyrtarizimi i nënshkrimit të marrëveshjes midis portugezit Cristiano Ronaldo edhe ekipit bardhezi, një operacion i cili duket disi i vështirë. Sulmuesi 33-vjeçar ende nuk ka dalë publikisht të thotë se ai dëshiron të iki, kusht ky i vendos nga presidenti Florentino Perez për ti hap derën. Revista "Copa" ka bërë me dije se Cristiano Ronaldo ka realizuar një bisedë telefonike me trajnerin e Juventusit, Maks Allegri. Mediat italiane kanë pohuar tashmë se Juventus do i paguajnë 130 milion euro dhe j 100 milion euro sa është përfolur nëpër mediat e tjera për portugezin.



Paulinjo rikthehet në Kinë

Paulinjo është zyrtarisht lojtari më i ri i Guangzhou Evergrande në Superligën e Kinës. Mesfushori largohet nga Barcelona pas një sezoni në Evropë ku luajti në 30 ndeshje dhe shënoi 9 gola me katalanasit në Spanjë. Mësohet se braziliani u rikthye te Guangzhou për shifrën e 50 milionë euro. Në këtë mes Barcelona fiton 10 milionë euro, pasi Paulinjo transferua në Barcelonë për shifrën e 40 milionë eurove. Pavarësisht se Barça del e fituar në para, kjo

lëvizje është cilësuar si një dështim për drejtuesit e klubit të cilët blenë një lojtar rreth 30 vjeç për 40 milionë euro, për më tepër nga një ligë e dobët, si ajo e Kinës. Në fund lojtari largohet duke u shprehur se nuk ka arritur të përshtatet me lojën e një ekipi që ka 10 vjet që luan njëjtë. Me këtë largim te Barcelona lirohet një vend ekstrakomunitari. Në këtë mënyrë talenti Arthur mund të bëhet lehtësisht pjesë e skuadrës.



Publicitet



Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopishtes

Tel:++389 2 27 85 100

Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opshtinasopiste.gov.mkNr. i procedurës: 15382
Nr. 28-33/18 nga 02.07.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për Tridellkovci, Komuna e Sopishtes.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për Tridellkovci, Komuna e Sopishtes.

Përfshirja planore dokument për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për Tridellkovci, Komuna e Sopishtes është me sipërfaqe prej 77552.18 m2.

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopishtes më datë **12.07.2018 në ora 10.00.**

6. Anketa publike do të zgjasë deri më **19.07.2018**, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopishte
Stefçe Trpkovski

Ju informojmë se shpallja me nr. 04-289/1 për zgjedhje të Drejtorit të IP QPS – Resnjë e publikuar në gazetën tonë nr. 3408 më datë 09.07.2018 do të fillojë të rrjedhë prej më datë 10.07.2018 dhe do të zgjasë 8 (tetë) ditë dhe shpallja me nr. 04-290/1 për zgjedhje të dy punëtorëve social dhe një mirëmbajtës të higjienës në IP QPS – Resnjë, e publikuar më datë në gazetën tonë nr. 3408 më datë 09.07.2018 do të fillojë të rrjedhë prej më datë 10.07.2018 dhe do të zgjasë 5 (pesë) ditë pune..

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

S'KA MË RONALDO APO MESSI

PESË FUTBOLLISTË NË GARË PËR "TOPIN E ARTË"

Specialistët e futbollit mendonin se Neymar ishte kandidati për të marrë fronin nga Ronaldo apo Messi, por një sezon i mbushur me dëmtime dhe dështimi në Kupën e Botës kanë ulur në minimum kuotat e brazilianit. Në këto kushte, pesë lojtarë kanë mbetur në garë për "Topin e Artë", trofeu që i jepet futbollistit më të mirë në planeti. Dy prej kandidatëve janë francezë. Kylian Mbappe ka fituar të katër trofetë e futbollit francez në sezonin 2017/2018 me Paris Sen-Zhermen dhe po lë një shije të mirë në "Rusi 2018". Dy ndeshjet që mund t'i kenë mbetur në Kupën e Botës do të jetë mundësia më e mirë për numrin 10 të Francës të mbledhë vota të tjera për "Topin e Artë", pasi u bë zyrtarisht kandidat me paraqitjen e shkëlqyer kundër Argentinës, ku shënoi dy gola dhe dha një asistim.

Nga ana tjetër, Antoine Grizmann është simboli i Atletiko Madridit, ka fituar trofeun e "Europa League" dhe është kandidat serioz nëse do të rezultojë vendimtar në suksesin e Francës



në Rusi. Kandidati tjetër është Luka Modrić. Ai do të bëhet favorit nëse fiton Kupën e Botës 2018 me Kroacinë, sepse ka në "xhepin" e tij edhe triumfin e tretë radhazi në Çampions Ligë me Real Madridin. Te Belgjika gjejmë kandidatin e katërt. Eden Hazard dhe Romelu Lukaku janë dy nga "yjet" e ekipit të Roberto Martinez, por sipër tyre, si pasojë e sezonit me Mançester Siti, ku u shpall kampion i Premier Ligë, qëndron Kevin de Bruine. Ai doli i dytë në Premier

Ligë, pas Sallah, në garën e futbollistit më të mirë në Angli, por e ka parakaluar egjiptian me paraqitjen në Rusi. Kandidati i fundit, por që ka shanse të barabarta me të tjerët është Harry Kin, golashënuesi më i mirë deri në këtë pikë të "Rusi 2018". Sulmuesi ka shënuar 30 gola (ose më shumë) në tre sezonet e fundit dhe nëse Anglia fiton Kupën e Botës, atëherë kapiteni i "luanëve" do të jetë pretendenti kryesor për "Topin e Artë".



Enrike, trajner i ri i Spanjës

Ndodhi ajo që e kishte paralajmëruar "Marca". Luis Enrike është zyrtarizuar si trajneri i kombëtares së Spanjës, duke pasur në këtë rol Julian Lopetegui, të shkarkuar një ditë para nisjes së Botërorit të Rusisë, dhe Fernando Hierro, që e drejtoi "La Roja" në Kupën e Botës së kësaj vere, deri në 1/8 finale, kur u eliminua me penallti nga vendi organizator. Ka qenë presidenti i Federatës Spanjolle të Futbollit, Luis Rubiales, ai që ka konfirmuar gjithçka para mediave, pas një mbledhjeje me bordin drejtues: "Kontraktimi i Luis Enriken për dy vitet e ardhshme si trajner i Spanjës është miratuar unanimisht nga bordi drejtues. Ka një marrëveshje të plotë për këtë emër dhe sigurisht javën e ardhshme ai do të paraqitet për prezantimin e tij", deklaroi Rubiales. Luis Enrike është ish-trajneri i Barcelonës dhe ish-lojtari i Real Madridit, dy gjigantëve të futbollit spanjoll. Bordi i drejtorëve e ka miratuar njëzëri emërimin e tij deri në "Euro 2020", me propozimin e presidentit Luis Rubiales. Ai nuk do të ketë një klauzolë ndërprerjeje të kontratës dhe vjen me stafin e vet teknik në këtë detyrë. Enrike do të japë listën e tij të parë të kombëtares iberike më 31 gusht. Ai do të zgjedhë 23 lojtarët për të luajtur kundër Anglisë në "Wembley", më 8 shtator, dhe kundër Kroacisë, në "Martinez Valero" të Elche, më 11 shtator, dy ndeshjet e para të Ligës së Kombeve. Enrike do të ketë në krah drejtorin e ri sportiv të RFEF, Hose Francisko Molina, që u zyrtarizua po ditën e djeshme.

Publicitet

Në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues të EVN Maqedoni SHA - Shkup për shitje të pronës së patundshme nr. 02-1930/2-3 të datës 26.06.2018 dhe Vendimit nr. 02-2010/1 të datës 05.07.2018 ndryshim dhe plotësim të Vendimit nr. 02-1930/2-3 të datës 26.06.2018 shpallim:

THIRRJE PUBLIKE nr. 2-1/2018

Për shitje të pronës së patundshme

1. Pronë e patundshme - SA (zyrë) në f. Rostushë, Dibër, FP 454 në v.th. Selovë KK Rostushë, në PK 313 pjesa 2 e cila përbëhet prej:

- ndërtesa 1, kati PR, hyrja 001, SA me sipërfaqe të përgjithshme prej 19 m²,
- PK 313/2 tpm me me sipërfaqe të përgjithshme prej 29 m².

me çmim fillestar prej 2.403,00 EUR (147.785,00 MKD)

Të drejtë të blerjes kanë të gjithë personat e interesuar juridikë dhe fizikë.

1. Çdo ofertues mund të dorëzojë vetëm një ofertë..
2. Mjeti themelorë - pronë e patundshme, lëndë e kësaj thirrjeje, shitet sipas principit "E parë e blerë" pa të drejtë në ankesë.
3. Për mjetin themelorë - pronë e patundshme, lëndë e kësaj thirrjeje, mund të realizohet kqyrje nëpërmjet personit Ilija Kirovski dhe të njëjtat të shihen me ndërmjetësim të EQK Strugë, çdo ditë pune prej orës 10 deri në orën 14.
Qasja në dokumentacion për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje mund të realizohet tek personi Ilija Kirovski në drejtorinë e EVN Maqedoni SHA Shkup, rr. "11 Tetori" nr.9, në periudhë prej 10.07.2018 deri më 17.07.2018, çdo ditë pune prej orës 10 deri në orën 14.
4. Ofertat të dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim: "MOS E HAP", OFERTA SIPAS THIRRJES PUBLIKE 2-1/2018 PËR SHITJE TË PRONËS SË PATUNDSHME (me shënim të numrit rendor dhe titullit të pronës së patundshme për të cilat dedikohen ofertat) deri më 14.07.2018, deri në orën 14.
5. Ofertat e dhëna nga personat fizikë duhet të përmbajnë: Çmim të ofruar në MKD pa TVSH; Pagesë të depozitit prej 30.000,00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi kopje nga ekzemplari nga pagesa e realizuar, emër dhe mbiemër të ofertuesit; numri i letërnjoftimit, adresa e banimit, e-adresa dhe telefoni për kontakt.
6. Ofertat e dhëna nga personat juridikë duhet të përmbajnë: Çmimi i ofruar në MKD pa TVSH; pagesë të depozitit prej 30.000,00 MKD për objektin për të cilin dorëzohet ofertë me dëshmi - kopje të ekzemplarit të pagesës së realizuar, emri i personit juridik dhe adresa (sipas regjistrimit); numri tatimor; xhiro-llogaria në vlerë të denarit dhe banka - deponues; emri i nënshkruesit të autorizuar dhe telefoni për kontakt, faksi dhe e-adresa.
7. Depoziti të paguhet në EVN Maqedoni SHA Shkup, xhiro-llogaria 210059337735190, Numri tatimor MK 4030005565759, Deponues NLB Tutunska Banka SHA Shkup.
Ofertat duhet të jenë të shkruara me kompjuter/makinë shtypi dhe të nënshkruara personalisht.

8. Ofertat dorëzohen personalisht në arkivin e "EVN Maqedoni SHA Shkup" - Shkup, rruga "11 Tetori" nr. 9, 1000 - Shkup ose nëpërmjet postës me afat të kufizuar. Ofertat duhet të arrijnë dhe të pranohen / të regjistruara në arkivin e "EVN Maqedoni SHA Shkup" - Shkup, rruga "11 Tetori" nr. 9, 1000 - Shkup më së voni deri më 17.07.2018, deri në ora 14:00. Ofertat të cilat do të arrijnë në arkivin e EVN Maqedoni pas afatit të shënuar nuk do të merren në shqyrtim.
9. Shitësi do të bëjë hapjen e ofertave të arritura gjatë së cilës Shitësi mba të drejtën të realizojë procedurë negociatash lidhur me ofertat pas dorëzimit të ofertave.
10. Shitësi ka të drejtë të aktivizojë depozitin, gjegjësisht të mos e kthejë depozitin e ofertuesit më të volitshëm nëse ofertuesi më i volitshëm (blerësi) nuk kryen pagesën e mjeteve në afat prej 14 (katërbëdhjetë) ditë pune nga data e konfirmimit për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm ose blerësi ka tërhequr ose ndryshuar ofertën pas afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
11. Depoziti i ofertuesve tjerë do të kthehet nga ana e EVN Maqedoni në afat prej katërbëdhjetë (14) ditë nga dita e hapjes së ofertave, gjegjësisht nga dita e procedurës së realizuar për negociatën, nëse shitësi realizon të drejtën që të realizojë procedurë për negociatën.
12. Afati për pagesë të mjeteve të përgjithshme financiare nga oferta është 14 (katërbëdhjetë) ditë pune nga dita e konfirmimit të zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm (Blerësi).
13. Shitja do të realizohet në pajtim me rregullat ligjore pozitive, të zbatueshme në pajtim me natyrën e objektit të patundshmërisë, lëndë e shitjes.
14. Shpenzimet të cilat do të burojnë nga shitblerja e pronës së patundshme (TVSH dhe tatimi i shitblerjes së pronës së patundshme) bien në barrë të Blerësit, gjithashtu edhe shpenzimet për verifikim të noterit janë në barrë të Blerësit.
15. Nëse ofertuesi më i mirë i zgjedhur nuk e paguan avansin në afatin e dhënë, pas kalimit të këtij afati llogaritet se nuk është i përzgjedhur për ofertuesin më të volitshëm.
16. Shitësi nuk është i obliguar ta pranojë cilëndo ofertë, gjegjësisht mban të drejtën të mos zgjedhë ofertuesin më të volitshëm për pronën e patundshme që është lëndë e kësaj thirrjeje publike.
17. Informacionet shtesë për shpalljen mund të merren prej orës 10 deri në orën 14, çdo ditë pune prej 10.07.2018 deri më 17.07.2018 tek personi:
 - për informacione për objektet dhe mundësinë e kqyrjes së objekteve ilija.kirovski@evn.mk, Ilija Kirovski tel. 02 205 000 lokali 43457 dhe 072 933 457.
 - për çështje komerciale radoslav.jauleski@evn.mk, Radoslav Jauleski tel. 02 3 205-000 lokali 43129 dhe 072 933 129.

EVN

DASHI 21. mars - 20. prill
 Ekzistojnë mundësitë që kjo e sotmja të jetë një ditë irrituese për ju në orët e para të mëngjesit. Duhet të jeni të gatshëm të përballeni me problemet që ju lindin. Nëse nuk do të jeni në gjendje të çlirohni prej problemeve, do të keni një ditë të keqe.

DEMI 21. prill - 21. maj
 Ajo që do të vihet shumë në pah sot është natyra juaj afektive. Njerëzit që ju rrethojnë duhet të ruhen prej jush dhe të bëhen gati të përballen me një fenomen të "pandalshtëm natyror". Do t'ju duket sikur të tjerët do të largohen prej jush, por kjo s'është e vërtetë.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
 Këtë ditë juve duhet të kujdeseni më shumë për financa, sidomos kujdes duhet të beni për pagimin e faturave. Shpesh i lini detyrat pas dore, por ky nuk është aspak veprim i zgjuar. Dita e sotme është e favorshme për të bërë transaksione financiare.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
 Sot ndiheni tepër të freskët nga ana mentale dhe ajo që duhet të bëni është të ushqeni trurin me me fakte dhe informacione të vërteta që të mund t'ju vlejné. Energjinë është më mirë ta shpenzoni në probleme që kërkojnë përgjigje me "po" ose "jo". Gjërat e ngatërruara nuk mund të zgjidhen sot.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
 Sot keni nevojë të "karikoheni" me energji. Sot është një nga ato ditë që energjitë u duhen për të qenë të gatshëm për ndonjë festë shoqërore. Nëse keni ndonjë plan, ndiqeni. Nëse nuk keni asgjë në axhendën tuaj, atëherë pushoni.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
 Sot është ditë e rëndësishme për ju. Kjo ditë është shumë e mirë për të bërë punët që deri më tani i kishit lënë pas dore. Nuk është koha juaj ideale për të nxjerrë në pah sharmin tuaj. Megjithatë përgatituni për aventurat që po vijnë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
 Sot pritet një ditë e mirë për të lindurit e kësaj shenje. Nëse keni planifikuar t'i shtoni pak shkëlqim ditëve tuaja, kjo është koha që po prisni. Socializohuni dhe bëni miq të rinj. Argëtimi është ai që ju nevojitet në këto çaste. Shijojeni jetën në çdo cast.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
 Këtë të hënë juve do merrni disa informacione të reja. Këto informacione do t'ju bëjnë t'i mendoni edhe një herë planet tuaja. Falë energjisë dhe mendjemprehtësisë do të dilni nga situata shumë lehtë. Megjithatë duhet të gjeni një rrugë të mirë komunikimi me kolegët!

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
 Sot pritet një ditë jo fort e mirë. Do ta keni të vështirë të merreni vesh me të tjerët sot, por ky nuk do të jetë problemi juaj i vetëm. Do të keni edhe mosmarrëveshje me kolegë të mërzitshëm. Mos u shqetësoni, gjithçka do të rregullohet së shpejti.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
 Sot pritet një ditë e mirë sidomos për të komunikuar me njerëzit që janë larg jush. Mbajini pranë personat tuaj më të dashur dhe do të ndiheni më të plotësuar në jetë. Çdo ditë është një bekim për t'u bërë një person më i mirë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
 Kjo e hënë është një ditë ku ju do ndiheni mjaft të sigurt për zgjedhjet tuaja. Mos ndiqni rrugën e të tjerëve, por shkoni në rrugën tuaj pasi do dini të gjeni drejtimin e duhur. Përqendrohuni në planet që keni dhe bëjini ato realitet!

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
 Këtë ditë juve jeni në gjendje mjaft të mirë pavarësisht se njerëzit do t'ju perceptojnë si shumë të ndjeshëm. Logjika është një nga armët tuaja të forta, ndaj përdoreni për të dalë nga situata që mund të mos jenë shumë të këndshme. Befasoni ndokënd!

Shtatë vjet pa me të dashurin tonë



Jeton (Tonçe) Duraku
 13.04.1966 – 10.07.2011

Perëndia të morri para kohe dhe vdekja na ndahu padrejtësisht! Nuk e besojmë akoma se ti nuk je më në mesin tonë.

Me lot e pikëllim të thellë: nëna Zinije, bashkëshortja Anita, djemtë Jetmiri dhe Tironi si dhe vajza Larglinda me bashkëshortin Jonuz Majtara, në Amerikë.

Shtatë vjet pa me të dashurin tonë



Jeton (Tonçe) Duraku
 13.04.1966 – 10.07.2011

Ike papritur duke hapur plagë në zemrat tona. Fjalët nuk mund të shprehin dhembjen dhe lotët nuk e shuajnë mallin për Ty.

Të kujtojnë motra Ermira me bashkëshortin Muhamer Papraniku në Dibër, si dhe vëllai Ramizi me bashkëshorten Zimen dhe fëmijët në Amerikë.


Shtatë vjet pa me të dashurin tonë



Jeton (Tonçe) Duraku
 13.04.1966 – 10.07.2011

Vitet kalojnë e assesi të mësohemi pa Ty. Dhembja sa vjen e shtohet, mungesa sa vjen e bëhet më e rëndë.

Të kujtojnë motra Ganimete me bashkëshortin Luan Shasivari dhe fëmijët në Shkup.

Mensur Mamuti	ISH BOKSIERI ITALIANO-AMERIKAN, NE FOTO	LLOJ PAPAĞALLI	AKTORI AMERIKAN, QË E LUAJTI ROLIN E BOKSIERIT NE FOTO, ROBERT	E RENDITA	LUMË NË MAL TË ZI	NE KETE DATE			
RRUGËT (BISED.)						 <p>10 KORRIK 1922 19 SHTATOR 2017</p>			
AKTORJA AMERIKANE, AMERIKA									
F									
KALLNOR									
BALTË E MADHE KU MUND TË FUNDOSËT KEMBA					FILMI I SKORSEZES PËR BOKSIERIN NE FOTO (NOFKA E BOKSIERIT)				
ISH BOKSIERI AMERIKAN, HOLMS									
AMPERI		ONE TIME KEY							
INICIALET E REGJISORIT TË FILMIT PËR BOKSIERIN NE FOTO			ALI ASLLANI REGJISOR I JAPONËZ, KUROSAVA						
FUTBOLLISTI JAPONËZ, KOSUKE				URUGUAJI LLOJ LOJE TË BILARDOS					
AUTOMOBIL UDHËTARËSH ME PAGESË					KËNGËTARE AMERIKANE, GABRIELLE OLIVIA MIRVILLE				
ISH FUTBOLLISTI BRAZILIAN					KOHA	SULMIMI	SHËNDËTËSI	KRYEPESHKOPI	
G					AUDIO SIGNAL PROCESSOR				
KOHA	SHTRUES I TRUMBËTËS PARANTEZA				ELEKTRO-MOTOR				
KALUMI		MATEMATIKANI GJERMAN, VILHELM SHKON, LARGOHËT							
LLI			GYPI I GJAKUT SAHATI			KARDASHIAN AKTORI ANGLEZ, OLIVER			
BASHKIM I HARMONISHËM I TRE OSE ME SHUMË TINGUJVE					KËNGËTARJA, ORA SHKRONJË GREKE				
NJË PARAFJALË				PËRGËZIMET FRANCA					
QË NUK ËSHTË I AFTË TË FEKONDOJË									

ZGJIDHJET: XHADET, FERERA, JANAR, KRIDHA, LARI, A, OTK, MS, AA, OTA, U, TAKSI, GARINÇA, ASP, TRUMBËTAR, K, AKERMANI, LLI, ENA, KIM, AKORD, RITA, PËR, URIMET, ANAFRODITI.

Mund të mbetemi pa banane!


Bananet rrezikohen të zhduken, paralajmërojnë ekspertët, pas përhapjes në të gjithë botën të një sëmundje tropikale vdekjeprurëse. E njohur si sëmundja Panama, ose *Fusarium oxysporum f.sp. cubense*, infeksioni fungal është përhapur tashmë në të gjithë Azinë, Afrikën, Lindjen e Mesme, Australinë dhe Amerikën Qendrore. Shkencëtarët paralajmërojnë se banania, një nga frutat më të shitura dhe të konsumuara në të gjithë botën, mund të zhduket nga kjo sëmundje. Edhe trajtimet me substanca kimike kanë rezultuar jo efektive për parandalimin e përhapjes së sëmundjes. Biologët po përpiqen të prodhojnë një hibrid të dy llojeve të ba-



nanes me shpresën që të zhvillojnë një virus kundër infeksionit. Shpëtimi mund të vijë nga një formë e rrallë e pemës

Madagaskane, ku rritet një lloj i veçantë i bananes që është imun ndaj sëmundjes Panama.

Ndryshime ekstreme të motit në gjithë planetin



Javët e para të verës janë shoqëruar me ndryshime ekstreme të motit në të gjithë planetin. Temperatura më të larta se zakonisht janë regjistruar në Lindjen e Mesme, por edhe në vende si Skocia, Kanadaja e Irlanda ku klima është zakonisht e butë. Vala e të nxehtit të padurueshëm është ndjerë më shumë nga irlandezët dhe britanikët, që panë me sytë e tyre shkriren e çatave nga temperaturat që arritën në 31.9 gradë në Glasgow dhe 29.5 gradë në Belfast. Në Tbilisi të Gjeorgjisë u shënua i nxehti rekord prej 40.5 gradë Celsius, ndërsa në Jerevan të Armenisë termometri tregoi 42 gradë në ditët e para të Korrikut. Kombinim i motit të ngrohtë dhe reshjeve në Amerikën e Ve-

riut. Në Montreal u regjistrua temperatura më e lartë e 147 viteve të fundit, 36.6 gradë. Tjetër panoramë në jugun e Europës dhe vendet e Ballkanit, ku Qershori rezultoi me reshje shiu dhe ulje të temperaturave. Greqia u godit së fundmi nga përmbajtje të mëdha në zonën e Atikës. Lumenj uji përmblytën shtëpi e banesa. Të gjitha këto të dhëna janë përfshirë në listën e ngjarjeve më ekstreme të motit që kanë ndodhur gjatë 15 muajve të fundit, ku veçohet temperatura 50.2 gradë në Pakistan dhe 53.7 gradë në Iran. Këto ndryshime konfirmojnë parashikimet e ekspertëve se ngjarjet ekstreme të motit do të shtohen me kalimin e viteve.

Vaksina që lufton HIV-in jep rezultat premtues

Trajtimi i pacientëve të infektuar me HIV zgjati për 48 javë. Rezultatet ishin befusuese thanë shkencëtarët, pasi u verifikuan trupa anti-HIV në sistemin e tyre imunitar. Mjekimi që synon të sigurojë imunitet kundër formave të ndryshme të virusit. Megjithatë shkencëtarët thonë se duhen bërë më shumë testime për të përcaktuar nëse reagimi imunitar i zhvilluar mund të parandalojë infeksionin HIV tek njerëzit. Rreth 37 milionë njerëz në botë janë të prekur me HIV apo AIDS, ndërsa 1.8 milionë raste të reja preken çdo vit. Në fillimet e testimeve vakcina rezultoi e suksesshme edhe te majmunët e prekur nga një nga virus i ngjashëm me HIV-in. Përgjigjet ishin gjithashtu shpresëdhënëse pasi 67% e majmunëve të testuar rezultuan të mbrojtur nga virusi.

Telefoni juaj po ju shikon!

Nëse keni pasur ndonjëherë dyshimin e hidhur se telefoni juaj mund t'ju vëzhgojë, hulumtimet e reja sugjerojnë se nuk jeni duke u bërë paranojakë. Shkencëtarët e hulumtimit në Universitetin Northwestern në Boston kaluan një vit duke u përpjekur të përcaktojnë nëse aplikacionet për smartfon po fshehin në fshehtësi bisedat tona private për të dërguar të dhëna personale tek reklamuesit. Për fat të mirë, studiuesit nuk gjetën ndonjë dëshmi për të mbështetur këtë teori të gjatë. Megjithatë, ata u penguan në një tjetër informatë shqetësuese: Ndërkohë që telefoni juaj mund të mos ju dëgjojë, po ju shikon. Studiuesit e Bostonit testuan 17.260 aplikacione popullore Android, shumë prej të cilave janë në

pronësi të Facebook - dhe 8000 prej tyre dërgojnë informacion direkt në Facebook. Studimi gjeti se më shumë se gjysma e aplikacioneve të shqyrtuara kishin leje për të hyrë në kamera dhe mikrofonin e përdoruesve. Kjo do të thotë se ato mund të aktivizonin këto veçori në çdo kohë, kur aplikacioni ishte i hapur. Shkencëtarët përdorën një sistem të automatizuar për të bashkëvepruar me aplikacionet, duke kërkuar për çdo dosje mediale që ishte dërguar prej tyre veçanërisht tek një palë e tretë. Kur një nga telefonat në studim përdorte një aplikacion për shpërndarjen e ushqimeve GoPuff, informacionet nga interaksioni i telefonit me aplikacionin u regjistruan dhe dërgoheshin në një domen të



palës së tretë të lidhur me Appsee. Regjistrimi i dërguar pranë kompanisë përfshinte edhe ekranin ku përdoruesit hynin në kodin e tyre postar për ofrimin e ushqimit.

48 BC - Beteja e Durrësit: Jul Cezari me vështirësi mënjanon mundjen katastrofale nga Pompej.

552 - Origjina e kalendarit armen.

988 - Themelohet qyteti i Dablinit në brigjet e Lumit Lifi.

1460 - Luftërat e Trëndafilave: Riçardi i Jorkut mund Mbretin Henri VI në Northampton.

1652 - Anglia i shpall luftë Holandës.

1778 - Revolucioni amerikan: Luigji XVI i Francës i shpall luftë Mbretërisë së Britanisë së Madhe.

1913 - Rumunia i shpall luftë Bullgarisë.

1919 - Presidenti Uilson personalisht dorëzon Traktatin e Versajës Senatit.

1925 - Themelohet Agjencia e lajmeve të BRSS, TASS.

1940 - Avionët gjerman sulmojnë anijet britanike në Kanal.

1943 - SHBA dhe Britania pushtojnë Sicilinë në Luftën e II Botërore (Operacioni Haski)


1960 - Belgjika dërgon trupa në Kongo.

1962 - Martin Luther King arrestohet gjatë protestave në Xhorxhia

1991 - Boris Jelcin betohet si kryetar i parë i Republikës Ruse.

KALENDARI HISTORIK 10 KORRIK

Në gjuhën e njeriut gjenden 100 lloje damarësh për të shijuar. Në sy gjenden 130 milionë qeliza shikimi.



Titaniku është anija që konsiderohet si anija e parë gjigante në botë. Kapaciteti ka qenë 46000 tonë, me gjatësi 268 m dhe lartësi 53 m. Mund të udhëtonin 1343 udhëtarë.



Lotët është zbuluar se kanë efekt që të zhdukin bakteriet dhe të mbrojnë sytë nga infeksionet.



UNAZA E VJEDHUR

Kishte ndodhur një vjedhje unaze dhe i pandehuri ishte thirrur në gjykatë!
Gjykatësi: Pra ti e vodhe atë unazë...
I pandehuri: Jo unë nuk e vodha por e gjeta.
Gjykatësi: Po pse nuk e dorëzove në polici?
I pandehuri: Nuk e dorëzova, sepse në të shkruhej "Përgjithmonë e Jotja".

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Gjithmonë falini armiqtë, asgjë s'i mërzi më shumë.
(Mark Twain)